

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit BSc në “Shkenca Kompjuterike”


me profil “Sistemet e Informacionit”

Universiteti i New York-ut në Tiranë

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Dr. Alketa GREPCKA

Prof. Dr. Thoma KORINI



Prill 2019

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit BSc. në Shkenca Kompjuterike me Profil Sistemet e Informacionit

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti i New Yorkut në Tiranë
2	Fakulteti /Departamenti që e ofron	Fakulteti i Informatikës / Departamenti i Informatikës Ekonomike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Licencuar me VKM Nr. 397, datë 15.08.2002, si program Bachelor. Riorganizimi si Bachelor, me 256 ECTS, me kohëzgjatje 4 vite studimi, me shkresë të MASR nr. 2160/1, datë 23.03.2018
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	UMASH nr. 385, dt. 10.10.2006
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në "Shkenca Kompjuterike", me profil "Sistemet e Informacionit"
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	4 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	256 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
11	Programi ofrohet vetëm nga institucioni	JO
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	PO Në bashkëpunim me Universitetin Shtetëror të New York-ut, Empire State College, (SUNY-ESC) New York, SHBA)
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	JO
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	PO (Bachelor in Computer Sciences with profile Information Systems)
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6
16	Numri i studentëve aktuale te regjistruar	Viti akademik 2016-2017 2 studentë Viti akademik 2017-2018 11 studentë Viti akademik 2018-2019 11 studentë

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me Profil Sisteme Informacioni

Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit ofrohet nga Universiteti i New Yorku-t në Tiranë (këtu më poshtë do të jepet nën emërtimin UNYT). Ky program studimi është liçensuar nga MASR Nr. 2160/1 prot., datë 23.03.2018 (Miratim i riorganizimit nga MP në Bachelor 4 vjeçar). Programi njihet nga UMASH Nr. 385, datë 10.10.2006 "Për njohjen e disa diplomave në Shkollën e Lartë Universitare Jopublike "New York University - Tirana", si kurs studimi me emërtimin "**Sistemet e Informacionit**". (sipas relacionit të Këshillit të Akreditimit, datë 08.06.2006 "Mendime dhe Rekomandime për Akreditimin e disa diplomave të Universitetit të New York-ut, Tiranë (UNYT).

Ky program është akredituar me Urdhër të MASH nr. 384, datë 06.09.2013, ku ai përmendet me emërtimin, "Shkenca kompjuterike", me profile: i. Sisteme të informacionit; ii. Shkenca Kompjuterike", (pika 1/g).

Programi riorganizohet si Bachelor, me 256 ECTS, me kohëzgjatje 4 vite studimi, me shkresë të MASR nr. 2160/1, datë 23.03.2018, me emërtimin **Bsc në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit** - bazuar në Vendimet Nr. 26, datë 15.06.2016; Nr. 37, datë 28.07.2017 dhe Nr. 42, datë 23.02.2018 të Senatit Akademik të IAL.

Programi 4-vjeçar Bachelor në UNYT në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit funksionon në bashkëpunim me State University of New York /Empire State College (ESC) në SHBA. Ky bashkëpunim është miratuar deri në datë 30.06.2022 dhe ofron diplomë të dyfishtë. Programi i studimit ofrohet në gjuhën angleze.

Programi Bachelor (4–vjeçar) në Shkenca Kompjuterike me Profil Sistemet e Informacionit ofrohet nga Departamenti i Informatikës Ekonomike i cili është pjesë e Fakultetit të Informatikës. Natyra ndërsiplinore e programit, kërkon një bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Shkencave Kompjuterike dhe me Departamentin e Ekonomiksit dhe Financës.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Prof. Dr. Thoma KORINI

Dr. Alketa GREPCKA

Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është bërë nga ASCAL /Bordi i Akreditimit. Menaxheri teknik (MT) i ndjekjes së vlerësimit të kësaj procedure është specialisti i ASCAL, ME. Renata Qatipi.

Më datë 03.04.2019, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 35/31 Prot., datë 03.04.2019 "Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm", UNYT është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

Më datë 08.04.2019, "UNYT" përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft – Raportin, me shkresë Nr. 129/2019 Prot., datë 05.04.2019 "Përgjigje për draft raportin e vlerësimit të jashtëm për programin e studimit Bsc në "Shkenca Kompjuterike", me profil "Sistemet e Informacionit", në kuadër të akreditimit periodik".

Në këtë dokument institucioni nuk ka bërë komente për Draft-RVJ dhe është dakort me vlerësimin.

Draft Raporti është edhe Raporti përfundimtar.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN PARAARDHËS

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- a) Të bëhen më shumë përpjekje për të rritur numrin e studentëve të pranuar në këtë program studimi.
- b) Të përmirësohet kërkimi shkencor për të mos mbetur vetëm në nivel institucional
- c) Të rritet numri i personelit mësimdhënës ndihmës.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

Për rekomandimin a): UNYT i kushton një vëmendje të veçantë përthithjes së studentëve më të mirë në këtë universitet. Kjo është e shprehur edhe në qëllimin nr. 3 në Strategjinë e Zhvillimit 2018-2022 të institucionit ku një theks i veçantë i kushtohet tërheqjes së studentëve më të mirë në këtë program. UNYT ka hartuar në terma afatgjatë edhe Strategjinë për Kërkim Tregu ku në fokus të saj është rritja e numrit të studentëve të rregjistruar. Në këtë drejtim kjo strategji fokusohet në analizën e Çmimit dhe të Konkurrencës. Në drejtim të rritjes së numrit të studentëve në këtë program studimi janë ndërmarrë takime të përvitshme me shkollat e mesme. Këto takime organizohen nga Zyra e Karrierës & Alumni në bashkëpunim me stafin akademik të Fakultetit të Informatikës Ekonomike.

Nga takimi me studentët evidentuam një shtrirje gjeografike të tyre nga Shkodra, Lushnja etj. të cilët kishin marrë informacion nga takimet e zhvilluara dhe nga fushatat mediatike të bëra. Institucioni përmes Zyrës së Karrierës dhe Alumni ndjek një politikë sensibilizimi dhe promovimi në lidhje me rritjen e numrit të studentëve të rregjistruar në këtë institucion.

UNYT përdor të gjithë mjetet dhe teknikat informuese në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit. Vlen të theksohen informim përmes:

- faqes së internetit
- <http://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/computer-science/>
- Manualit të Studentit (Student Handbook);
- Ditës së orientimit;
- Koordinatorit të programit.
- Rrjete sociale si facebook, instagram, twitter etj.

UNYT ndjek një politikë të qartë edhe në lidhje me zbatimin e kriterëve të pranimit të studentëve në këtë program studimi. Këto kriterë janë në përputhje me standartet dhe kërkesat që legjislacioni shqiptar në fuqi ofron dhe në akordancë me Rregulloren e Studimit. Mundësia e ofrimit të një diplomë të dyfishtë bën që ky institucion në të njëjtën kohë të ndjekë edhe kriterë pranimi dhe transferimi të studentëve në SUNY – ESC University (SHBA).

Konkludojmë që UNYT ndjek një politikë të qartë në lidhje me rritjen e numrit të studentëve për këtë program studimi. Megjithatë evidentuam se ky numër është akoma i vogël. Për vitin 2018-2019 janë vetëm 4 studentë të rregjistruar për herë të parë. Ndonëse në kriteret shtese mesatarja e notës për pranim

është 6.5, rezulton se studentët e përthithur në këtë program studimi kanë një mesatare note për periudhën 2013-2018 mbi 8.5 dhe vetëm për vitin akademik 2018-2019 kjo mesatare është 9.2. E konsiderojmë këtë një tregues të cilësisë së pranimit të studentëve në këtë program studimi.

E parë në këndvështrimin tonë si ekspert e konsiderojmë këtë rekomandim të plotësuar nga ana e UNYT. Plotësimin i tij e konsiderojmë të përmbushur në aspektet si vijon:

1. UNYT ka hartuar politikë marketingu dhe e zbaton atë në të gjithë format e saj në drejtim të promovimit dhe sensibilizimit të komunitetit në lidhje me programin e studimit;
2. UNYT ka ngritur të gjithë strukturat e duhura për të mbështetur promovimin dhe pranimin e studentëve në programin e studimit;
3. Studentët e regjistruar janë me notë mesatare të lartë ç'ka shpreh edhe cilësinë e pranimit për këtë program studimi.

Numri i ulët është rezultat edhe i konkurrencës dhe luhatjeve ekonomike të vendit ç'ka edhe UNYT shprehet në RVB në analizën SWOT.

Rekomandimi është përmbushur plotësisht.

Për rekomandimin b): UNYT i kushton një vëmendje rritjes së kërkimit shkencor. Në vitin 2017-2018 kemi një ristrukturim të Fakultetit të Informatikës tashmë i përbërë nga dy departamentë përkatësisht Departamenti i Shkencave Kompjuterike, Departamenti i Informatikës Ekonomike ku ofrohet edhe programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit dhe si njësi e tretë e saj është ngritur Qendra për Kërkime të Avancuara Kompjuterike e cila në strukturën e saj ka 7 anëtarë. Pjesëmarrja në projekte kërkimore shkencore është rritur. Për vitin 2013-2018 rezultojnë 4 projekte të zbatuara dhe 9 në proces. UNYT ka ngritur një sistem monitorimi dhe vlerësimi të performancës individuale të stafit akademik në lidhje me kërkimin shkencor.

Rezultati (output) shkencor individual vlerësohet sipas kategorizimit dhe është i rregulluar me dokumentin "Weight of Research Output" në të cilin kategorizohen rezultatet shkencore dhe intelektuale dhe ku secilit i jepet pesha e merituar.

Kërkimi Shkencor në funksion të Programit të Studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me Profil Sistemet e Informacionit bën pjesë në shtyllën nr. 2 (Inxhinieria Softuerike dhe Sistemet e Informacionit) dhe në shtyllën nr. 3 të kërkimit institucional (Shkenca, Teknologjia dhe Shoqëria). Në shtyllat kërkimore për vitin 2018-2022, kjo fushë është promovuar si shtyllë kërkimore më vete. Kërkimi shkencor në Fakultetin e Informatikës, dhe veçanërisht për këtë program studimi ka në fokus edhe rritjen e pjesëmarrjes së studentëve. Aktualisht për këto fusha kërkimi studentët inkurojohen të trajtojnë tema të diplomës të cilat janë në përputhje me fushën prioritare të këtij program studimi në drejtim të kërkimit shkencor.

Konkludojmë të përmbushur këtë rekomandim për kriteret që vijojnë:

- UNYT ka hartuar dokumentat bazë si Strategjia për Kërkim Shkencor dhe mbështet zhvillimin e saj në 5 shtylla bazë. Kërkimi Shkencor për këtë program studim është i inkorporuar në shtyllat bazë të Kërkimit Shkencor Institucional.
- UNYT ka ngritur strukturat e duhura për mbështetje dhe forcim të Kërkimit Shkencor;
- UNYT synon integrim të studentëve në drejtimet e kërkimit shkencor;

Rekomandimi është përmbushur plotësisht.

Për rekomandimin c): Krijimi i Fakultetit të Informatikës dhe strukturimi i tij në dy departamente dhe njësi Kërkimi Shkencor ka sjellë edhe një rritje të numrit të stafit akademik në 21 duke plotësuar

standartet ligjore dhe përmbushje të kërkesave të mësimdhënies me staf akademik me kohë të plotë. E parë në kënvështrimin e standarteve e konsiderojmë të përmbushur këtë rekomandim si vijon:

1. UNYT ka formuar strukturë të re (Fakulteti i Informatikës) i cila ka sjellë edhe forcim institucional dhe vendimarrje të programit të studimit;
2. Numri i stafit akademik me kohë të plotë është rritur në 21 ku nevojat për këtë program studimi mbulohen nga Departamenti i Informatikës Ekonomike dhe nga Fakultetet e tjera.

Eventualisht, për të garantuar një qëndrueshmëri të personelit duhet synuar një rritje e tij mbi kufijtë minimalë të kërkuar nga standartet.

Rekomandimi është përmbushur plotësisht.

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Programi 4-vjeçar Bachelor në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit në UNYT funksionon në bashkepunim me State University of New York /Empire State College (ESC) në SHBA. Ky bashkëpunim është i bazuar mbi një marrëveshje institucionale me afat deri në datë 30.06.2022. Përmes këtij bashkëpunimi UNYT ka mundur të ofrojë diplomë të dyfishtë nga një për secilin shtet, të njohur në Shqipëri dhe në SHBA për të gjithë studentët që janë të interesuar në këtë drejtim **[dok. 9 – Mendimi i Dekanit]**.

UNYT ka të ngritur një strukturë të qartë institucionale. Funksionimi i programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit është i integruar në përmbushjen e misionit të institucionit i shprehur ky në nenin 3 të Statutit të UNYT **[dok1: Statuti i UNYT]**. Në misionin e programit synimi kryesor është krijimi, zhvillimi, përcjellja dhe mbrojtja e dijeve tek studentët, përgatitja dhe mbështetja e studentëve të dalluar për të krijuar një bazë e cila në të ardhmen do të shërbejë si bazë profesionale dhe akademike në mësimdhënie. Në këtë synim evidentojmë kombinim të njohurive dhe praktikës laboratorike si kolonat bazë të funksionimit të programit të studimit.

Misioni i programit të studimit është i integruar në misionin e përgjithshëm të universitetit. Në fokus kryesor të misionit të universitetit vlen të përmenden **[dok. 1: neni 3, Statuti i UNYT]**:

- Përvetësimin e aftësive të komunikimit dhe zhvillimit të dijeve me gojë dhe me shkrim në gjuhën angleze.
- Formimin e aftësive të mendimit analitik, sintetik dhe kritik;
- Zhvillimin e metodave të kërkimit shkencor, duke përfshirë aftësinë për të përcaktuar, vlerësuar dhe sintetizuar informacione dhe të dhëna;
- Zhvillimin e marrëdhënieve të qëndrueshme ndërpersonale dhe shoqërore;
- Kuptimin, rëndësinë dhe sfidat e përdorimit të teknologjisë moderne;
- Zhvillimin e aftësive dhe të sjelljeve të nevojshme për t'u bërë ekspertë profesionalë në fushat e studimit;

Programi i studimit ka objektiva të qarta të shprehura si më poshtë:

- Të kuptojë procesin e analizimit, projektimit dhe zhvillimit të sistemeve të informacionit bazuar në software për probleme komplekse.
- Të bëhet kompetent në menaxhimin e sistemeve të informacionit dhe në mirëmbajtjen e tyre me synimin përfundimtar të optizimit të procesit të vendimarrjes.
- Të bëhet kompetent në realizimin me sukses të zgjidhjeve praktike që kanë të bëjnë me implementim sistemesh informative bazuar në software, ndërtim dhe manipulim databazesh, ndërtim dhe menaxhim rrjetash për ngritjen e infrastrukturës bazë të një sistemi informativ.

Përmbushja e objektivave të programit të studimit bëhet mbi bazën e një plan veprimi të shprehur në strategjinë e zhvillimit ku jepen qartë edhe 7 qëllimet bazë të cilat janë në përputhje edhe me qëllimet e programit të studimit **[dok/ 14 – Strategjia e zhvillimit 2018 – 2022; dok.15 – Strategjia e zhvillimit 2012 – 2017]**;

Referuar planit strategjik për vitet 2017-2022 zhvillimi i programeve të studimit të ofruara nga UNYT mbështetet në kolonat kryesore:

1. Zgjerimi dhe mbështetja e Axhendës Kërkimore dhe Produkteve të UNYT-it;
2. Përmirësim i vazhdueshëm i infrastrukturës përmes përmirësimit të laboratoreve dhe infrastrukturës mesimore dhe pasurimit të bibliotekës;
3. Rekrutimi, mbajtja dhe diplomimi i një trupi studentor të ndryshëm i cili dëshiron të ndikojë në ekonominë dhe shoqërinë shqiptare;
4. Nxitja e nje kulture ndërkombëtare përmes rekrutimit të studentëve ndërkombëtare si edhe përmes zgjerimit të rrjetit të bashkepunimit dhe aleancave me universitete të tjera dhe institucione kërkimi në botë.
5. Përpjekje për përmirësim në mësimdhënie;
6. Të mbajë dhe të forcojë një Rrjet Partnership-i me institucione të ngjashme.
7. Mirëmban një qëndrueshmëri financiare;

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit zhvillohet mbi bazën e një strategjie afatgjatë zhvillimi e cila mbështetet në pesë kolonat kryesore [dok.11-**Strategjia e zhvillimit te programit te studimit 2018 – 2022, Takim me stafin drejtues të UNYT dhe Fakultetit të Informatikës Ekonomike**]

1. Forcimi i bashkëpunimit të suksesshëm me State University në New York;
2. Tërheqja e studentëve të huaj kryesisht nga rajoni i Ballkanit;
3. Rritja e investimeve në infrastrukturën mesimore dhe laboratorët;
4. Rritja e përpjekjeve në marketing për një perceptim më të mirë të programit në vend dhe jashtë;
5. Rritja e angazhimit të studentëve në nivelin Bachelor në aktivitete kërkimore.

Përmes anagzimit të një stafi të specializuar dhe përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës së studimit, ky program studimi synon që studentët në fund të studimit të tyre të jenë të aftë në tregun e punës përmes një kombinimi të njohurive të mara në këtë program studimi dhe aftësimin profesional të tyre.

GVJ është i mendimit se misioni dhe objektivat e programit të studimit janë në përputhje ne strategjinë afatgjatë të UNYT.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit funksionon mbi bazën e një misioni dhe qëllimi të qartë të cilin e gjejnë të integruar në misionin e përgjithshëm të institucionit. Takimet dhe evidencat dëshmojnë që programi i studimit është i ndërtuar mbi objektiva të qarta. Këto objektiva pasqyrohen në Statutin e Universitetit dhe në Rregulloren e programit të studimit. Në qendër të tyre është aftësimi i studentëve, zhvillimi personal i tyre dhe krijimi i specialistëve në fushën e sistemeve të informacionit.</p> <p>Evidentojmë një përmirësim të vazhdueshëm të programit të studimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimeve të teknologjisë të bazuar në hulumtimet e bëra nga studim të tregut në 2013 në rang institucioni dhe mbi bazën e</p>

	një Strategji Kërkim Tregu [aneksi 10- Strategjia ne Kerkim Tregu; aneksi 9-Studim tregu mbi kërkesën dhe disponibilitetin e profesionisteve të shkolluar në fushen e teknologjisë dhe informacionit dhe Menaxhimit të Biznesit].
--	---

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;

Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;

Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;

Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit zhvillohet përmes 5 kolonave kryesore të një strategji afagjatë ndërtimi i të cilës është në përputhje me 7 qëllimet bazë të strategjisë institucionale të universitetit [dok/ 14 – **Strategjia e zhvillimit 2018 – 2022; dok.15 – Strategjia e zhvillimit 2012 – 2017**];

Në këtë program studimi synohet në marrjen e një shumëllojshmërie konceptesh teorike dhe aplikime të sistemeve të shkencave kompjuterike dhe informacionit. Në qëndër të programit qëndron aftësimi i studenteve në identifikimin e problemeve, analizën, dizajnin dhe zhvillimi e një sistemi software, zgjidhjen e problemeve dhe aftësimin praktik të tyre. Në aspektin e menaxhimit ky program mundëson njohjen dhe zbatimin praktik në menaxhimit ekektiv të informacionit, organizimit të tij duke përfshire tekstin, imazhin, tingujt dhe videot; zbatimin e parimeve të ndërveprimit operator-kompjuter me vlerësimin dhe ndërtimin e një gamë të gjerë materialesh duke përfshirë ndërfaqjet e përdoruesit, faqet e internetit dhe sistemet multimediale.

Ky program studimi është në funksion të aftësimin praktik të studentëve dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Përmes këtij programi studentët në fund të diplomimit të tyre kanë një spektër të gjerë punësimi në drejtimet: computer systems analysis and design, software engineering, systems administration, database design and management, Internet and Web design [dok 11- **Rregullore e programit të studimit/student handbook**];

Përmirësimi i vazhdueshëm i programit nën supervizionin e State University of New York/Empire State College (SHBA) dhe ofrimi në gjuhën angleze të tij garantojnë cilësinë dhe avantazhin konkurrues në treg.

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.

Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;

Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:

- a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;
- b. kërkesat e punëdhënësve;
- c. një parashikim të përafërt për numrin e

Ndërtimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit bëhet mbi bazën e një strategjie kërkimi tregu dhe mbi bazën e studimit të tregut. Në fokus të tij qëndron praktika për përthithjen e studentëve përmes një analize edhe të ndjeshmërisë në çmim dhe përmirësimi i programeve të studimit përmes fokusit në analizën konkurruese me institucionet dhe programet e ngjashme dhe feedback-ut nga studentët e diplomuar. Dëshmi u dhanë në takime dhe evidenca

<p>pritsëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</p> <p>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p>	<p>të qarta u siguruan për studim tregu të ndërmarrë nga institucioni ndonëse nuk ka një strategji të veçantë për këtë program studimi dhe studimi për tregun e punës i përket vitit 2013, i cili është në nivel institucional.</p> <p>Numri i ulët i studenteve, dëshmon për domosdoshmërinë e përmirësimit të strategjisë së kërkimit në treg për këtë program veçanërisht në përthithjen e studentëve të rinj e kombinuar kjo me një politikë të qartë marketingu.</p>
<p>Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit ka në fokus të tij tendencat dhe zhvillimet teknologjike. Përmes tij diplomohen studentë të cilët kontribuojnë në fushën e inxhinierisë kompjuterike duke u punësuar në sektorë të ndryshëm dhe duke dhënë kontributin e tyre në zhvillimin e ekonomisë. Përmes formimit të përgjithshëm, studentët marrin aftësi në zhvillimin personal të tyre, aftësimin në menaxhim dhe vendimmarrje. Programi kontribuon në ruajtjen e vlerave kulturore dhe kombëtare. Sistemi antiplagjiarizëm mundëson studentët të aftësohen në punën individuale konkrete dhe në njohjen, ruajtjen dhe mirëmenaxhimin e studimeve bashkëkohore.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit zhvillohet mbi bazën e një strategjie afatgjatë. Objektivat në këtë program studimi janë të qarta dhe ndërthuren me objektivat afatgjatë të UNYT. 2. Programi synon aftësimin e studentëve në tregun e punës përmes përthithjes së njohurive të thelluara profesionale në këtë fushë. 3. Rekomandojmë zbatimin e strategjisë në kërkim tregu me fokus të veçantë në përthithjen e studentëve në këtë fushë përmes kombinimit të tij me politika të qarta marketingu veçanërisht për këtë program studimi. 	

2. Struktura akademike e Fakultetit/ Departamentit përgjegjës për programin e studimit

UNYT përbëhet nga tre fakultete:

- Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit
- Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore
- Fakulteti i Informatikës

UNYT ofron programe studimi për të tre ciklet e studimit si dhe realizon kërkim shkencor bazë dhe të aplikuar me anë të njësive përbërëse.

Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit ofrohet nga Departamenti i Informatikës Ekonomike në Fakultetin e Informatikës.


Fakulteti i Informatikës është krijuar në vitin 2017 dhe përbëhet nga njësitë bazë si vijon më poshtë:

- Departamenti i Shkencave Kompjuterike
- Departamenti i Informatikës Ekonomike;
- Qendra për Kërkime të Avancuara Kompjuterike;

Në historikun e tij Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit ka qenë deri në vitin akademik 2016 –2017 pjesë përbërëse e Departamentit të Shkencave Kompjuterike, pjesë përbërëse e Fakultetit të Drejtësisë, Arteve dhe Shkencave. Themelimi në vitin akademik 2017 – 2018 i Fakultetit të Informatikës dhe inkomporimin e këtij program studimi në Departamentin e Informatikës Ekonomike e konsiderojmë pozitiv në drejtim të përputhjes dhe përmbushjes së misionit dhe objektivave të këtij programi.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit



Fakulteti i Informatikës, për vitin akademik 2018-2019 ka në përbërjen e tij 21 pedagogë si personel akademik efektiv (3 Prof., 3 Prof.Asoc., 6 Dr., 3 Dr. në proces, 6 MSc) dhe 8 PAK. Të tre njësitë e fakultetit koordinojnë veprimtaritë mësimore dhe shkencore. Departamenti i Informatikës Ekonomike për këtë program studimi koordinon punën edhe me njësitë bazë të Fakultetit të Eknomisë dhe Biznesit duke konsideruar që një pjesë e moduleve të këtij programi ofrohen nga ky fakultet.

Vlerësojmë që ky Fakultet përmbush edhe kriterin për një staf akademik efektiv me grada shkencore dhe me numër të konsiderueshëm për të përmbushur standartin për mësimdhënie.

- Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti i Informatikës Ekonomike ka në përbërjen e tij 7 PAE, nga të cilët 1 Prof.Dr., 2 Dr., 1 Dr. në proces, 3 MSc. Në këtë mënyrë, edhe për Departamentin e Informatikës Ekonomike konkludojmë që plotësohen kushtet minimale numerike të personelit akademik efektiv.

Duke krahasuar të dhënat statistikore në lidhje me numrin e personelit akademik efektiv dhe me kohe të pjesshme për periudhen 2013 – 2019 [te dhenat i referohen numrit të stafit akademik në Departamentin e Shkencave Kompjuterike për periudhën 2013 – 2017 dhe të Departamentit të Informatikës Ekonomike përkatësisht në Fakultetin e Informatikës për vitet akademike 2017 -2018 dhe 2018-2019 konkludojmë si vijon:

Viti akademik	Personeli akademik efektiv (PAE)	Personeli akademik me kontratë (PAK)
2013 - 2014	8	15
2014 - 2015	9	8
2015 - 2016	7	7
2016 - 2017	7	4
2017 - 2018	7	3
2018 - 2019	7	3

Evidentojmë një zvogëlim të stafit akademik me kohë të pjesshme për këtë program studimi. Krahasuar me vitin akademik 2013-2014 (15 PAK) për vitin 2018 – 2019 kemi një angazhim minimal në 3 PAK. Nga ana tjetër krijimi i Fakultetit të Informatikës Ekonomike në vitin akademik 2017-2018 dhe krijimi i tre njesive bazë ka sjellë edhe në rigrupim të stafit akademik duke arritur numrin minimal të duhur të këtij stafi efektiv për të përmbushur kriterin për njësi bazë.

Ristrukturimin e programit të studimit në vitin akademik 2017 – 2018 në Fakultetin e Informatikës Ekonomike e konsiderojmë pozitiv në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të këtij program studimi dhe përmbushjes së qëllimit dhe misionit të tij. Bashkëpunimi me njësitë bazë të Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit mendojmë se përbën një avantazh në lidhje me cilësinë e mësimdhënies duke shfrytëzuar një staf akademik efektiv me eksperiencë në këtë fushë [**tak me stafin akademik ku presente ishin 3 akademik nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit**].

Krijimi në vitin akademik 2017 – 2018 i Qendrës për Kërkime të Avancuara Kompjuterike përbën një hap pozitiv në lidhje me rritjen e cilësisë së programit të studimit dhe integritit të kërkimit shkencor në përmbajtjen e kurrikulave dhe aftësitë të studentëve përmes integritit të tyre në aktivitete shkencore. E konsiderojmë këtë qendër vulnerable dhe me impakt akoma të pamatur në programin e studimit dhe për këtë **rekomandojmë një konsolidim të mëtejshëm të saj përmes zbatimit të një strategji afatgjatë të Fakultetit të Informatikës në drejtim të kërkimit Shkencor.**

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit ofrohet nga Departamenti i Informatikës Ekonomike. Deri në vitin akademik 2016 – 2017 ky program studimi ofrohej nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike në Fakultetin e Drejtësisë, Arteve dhe Shkencave.

Për periudhën akademike 2013 – 2019, për këtë program studimi janë angazhuar staf akademik, si më poshtë:

Viti akademik	Personeli akademik efektiv (PAE)	Personeli akademik me kontratë (PAK)
2013 - 2014	21	12
2014 - 2015	16	6
2015 - 2016	28	5
2016 - 2017	26	5
2017 - 2018	28	7
2018 - 2019	20	5

Në praktiken e rekrutimit synohet përzgjedhja e një stafi me eksperiencë me synimin e rritjes së ndërkombëtarizimit të programit dhe ofrimin e një ekspertize në module të specializuara të programit. Për këtë program studimi angazhohen 1 Prof., 1 Dr. dhe 1 MSc. të punësuar kryesisht nga Universiteti Politeknik i Tiranës.

Evidentojmë se:

1. Numri i stafit akademik (PAE) është i mjaftueshëm për të mbuluar programin mësimor;
2. Evidentojmë një konsistencë të stafit akademik PAE për periudhën 2013 – 2019;
3. Raporti student/PAE është brenda normës dhe konkludojmë që ky raport favorizon një punë të stafit akademik me studentët gjë e cila u theksua nga takimi me stafin akademik dhe me studentët.

Referuar të dhënave të RVB [Dok.2] si dhe të dhënave të mara gjatë vizitës në UNYT (e që në mënyrë të detajuar pasqyrohen në anekse), të dhëna të përmbledhura që i korrespondojnë 6 viteve të fundit akademike paraqiten në Tabelën 5.4.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat** (Tabelat 4 dhe Tabelat 5)

Të dhënat për numrin efektiv (PAE) dhe personelin akademik me kontratë reflektohen në tabelat 5.1, 5.2 të pasqyruara në aneks te raportit.

GVJ është i mendimit se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, ka kualifikimin e duhur për të zhvilluar një proces mësimor cilësor dhe në përputhje me standartet. Gradat shkencore dhe eksperiencia e stafit akademik me kontratë janë në përputhje me standartet e kërkuara.

- Të dhëna sipas moshës së personelit** (Tabelat 6)

Bazuar mbi të dhënat në lidhje me grup – moshat për stafin akademik efektiv (PAE) dhe me kontratë të angazhuar për këtë program studimi evidentojmë:

- a. Kategoria profesor i përket grup – moshës 46-55 vjeç;
- b. Kategoria Professore të Asociuar i përket grup – moshës 46-55 vjeç;
- c. Kategoria Dr. i përket të katër grup – moshave 25-65 vjeç;
- d. Kategoria Pedagogë në proces Dr dhe MSc. i përkasin grup moshës më të re përkatesisht 25-35 dhe 36-45 vjeç
- e. Personeli akademik ndihmës i përkasin grup moshës 25-35 vjeç në masën 70%.

GVJ është i mendimit se moshja e personelit akademik, si atij efektiv dhe atij me kontratë, garantojnë realizimin cilësor aktual dhe perspektiv të programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit.

Nga analiza e të dhënave në Tabelat 6 në Aneks, rezultojnë këto ndarje në përqindje në grup moshat (për srafin akademik për vitin 2018-2019)

Tabela 6/1

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i PAE me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë	0	0	4.1%	8.3%	0
Profesorë të As.	0	12.5%	0	0	0
Dr/PhD	20.8%	16.6%	8.3%	4.1%	0
Pedagogë ne proces Dr	4.2 %	4.1%	0	0	0
Asistentë me Msc	12.5 %	8.3%	0	0	0
Personeli ndihmës akademik	70 %	10%	15%	5%	0

Tabela 6/2

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i PAK me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë	0	0	20%	0	0
Profesorë të As.	0	20%	0	0	0

Dr/PhD	40%	0	0	0	0
Pedagogë në proces Dr	0	0	0	0	0
Asistentë me Msc	0	20%	0	0	0
Personeli ndihmës akademik	0	0	0	0	0

Vëmë re një shpërndarje të duhur të stafit akademik me grada shkencore. Tabela vërteton edhe atë çfarë u theksua edhe në takime, për një fokus të institucionit në përzgjedhjen e një stafi akademik me kontratë me grada të duhura shkencore. Në masën 40% i përkasin grup moshës 25-35 vjeç e cila vërteton synimin dhe politikën e institucionit për të përthithur staf të ri dhe me përvojë kryesisht nga universitete të njohura shtetërore si Universiteti Politeknik i Tiranës.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

UNYT ndjek një politikë të qartë në lidhje me rekrutimin e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Në këtë politikë synohet përzgjedhja e një stafi me grada shkencore të larta dhe që mbartin eksperiencë. Synohet edhe përthithja e një stafi të huaj për të rritur ndërkombëtarizimin e programit dhe njëkohësisht për të sjellë përvojën dhe eksperiencën më të mirë në kuadrin teorik dhe praktik. **[statut i UNYT neni 38]**. Kjo politikë është e sanksionuar edhe në Statut në nenin 38 të saj. UNYT ka të ngritur edhe zyrën e Burimeve Njerëzore detyrat dhe funksionet e të cilës janë të përcaktuara qartë edhe në Statutin e universitetit.

Në lidhje me procedurat e rekrutimit të stafit akademik u njohën me dokumentacionin bazë **[Aneksi 7: Politika e BNJ dhe e punësimit; Aneksi 7.1: Faculty Selection Criteria & Procedures; Aneksi 7.3: Shembull i kontratës së stafit akademik me kohë të plotë; Aneksi 7.4: Shembull i kontratës së stafit akademik me kohë të pjesshme]**. Një takim i veçantë u organizua edhe me zyrën e Burimeve Njerëzore ku verifikuam procedurën e rekrutimit **[u pane materiale të procedurës]** dhe dokumentacion të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme të zgjedhur në mënyrë rastësore.

Procedura e rekrutimit funksionon në disa hapa/faza të cilat janë si më poshtë:

1. *Aprovimi i Buxhetit*: Procedura fillon me nevojën e identifikuar nga Njësia bazë dhe/ose dekani. Rektori ose person i autorizuar nga ai përcakton edhe aprovimin e buxhetit nga Shefi Administrator i UNYT.
2. *Hapja e njoftimit*: Pas aprovimit të buxhetit një memo e brendshme krijohet nga Rektori duke theksuar: datën e vendimit, emrin e postit, fakultetin, departamentin përkatës, kualifikimet akademike të nevojshme, pagën bruto (pagën për orë për rastet e rekrutimit të stafit akademik me kohë të pjesshme), kohëzgjatjen e punësimit, modulet që do japë mësim. Pas nënshkrimit të kësaj memo nga Rektori dhe Shefi i Administrimit, shpërndahet tek Zyra e Burimeve Njerëzore e cila bën edhe shpalljen e vendit vakant në median elektronike dhe të printuar.
3. *Mbledhja e dosjeve të aplikanteve* në adresën hr@unyt.edu.al
4. BNJ janë përgjegjës për mbledhjen e aplikimeve dhe dorëzimin e tyre tek Shefi i Departamentit. Për shqyrtimin e tyre ngrihet edhe një komision kërkimi (faculty research committee) i cila bën edhe shortlistën e kandidatëve mbi bazën e kritereve të vendosura. Ky komision përbëhet nga Shefi i Departamentit, tre (të paktën 2) anëtarë të Fakultetit në disiplina të ngjashme dhe një ekspert i jashtëm. Minutat e intervistave të kandidatëve potencialë ruhen brenda dy ditëve pas dhënies së intervistës. Përzgjedhja e kandidatëve nga komisioni bëhet të paktën një muaj nga data e pritshme e fillimit të punës së kandidatit të suksesshëm.

Në përzgjedhjen e kandidatëve merren në konsideratë kriteret e mëposhtme:

1. Niveli i edukimit arsimor (kryesisht preferohen me gradë Doktoraturë)
2. Dëshmi në dhënie mësimi dhe eksperiencë kërkimore

3. Cilësia në kërkimin shkencor (bazuar në llojin e publikimeve të bëra)
4. Eksperiencë në mësimdhënie dhe filozofi;
5. Orientimi në arsimdhënie dhe eksperiencë në lidhje me misionin e UNYT. Për këtë për akademikët e rinj bëhet edhe një ditë e veçantë ku jepen trajnime në lidhje me filozofinë dhe mësimdhënien [takim me stafin akademik].
6. Potenciali për një zhvillim të mëtejshëm në UNYT.

Bazuar edhe në aneksin 7.2: Faculty Selection Criteria & Procedures u bë edhe një takim në Zyrën e Burimeve Njerëzore. U verifikuan këtu edhe dokumentacioni përkatës për një staf akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme dhe konkludojmë së gjetjet janë në përputhje midis procedurës së rekrutimit dhe dokumentacionit aktual në këtë zyrë.

Dokumentacioni mbahet në formë elektronike (ndonëse për shkak të ndryshimit të partnerëve kjo zyrë po bënte edhe ndryshimet përkatëse mbi mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit përkatës) dhe në dosje të cilat ruhen edhe në arshive [vizita në fakultet].

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ

Sipas RVB dhe nga konstatimet gjatë vizitës në vend, nga pikëpamja administrative, programi mbështetet nga zyra të tjera të tilla si Zyra e Regjistrave, Zyra e TI-së, zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Operacionale. Në mënyrë të veçantë zyra e TI, që ka në përbërje 3 persona, është e një ndihmese të madhe për mbështetjen e procesit mësimor në laboratorët përkatës informatikë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>UNYT ka të sanksionuar politikën e rekrutimit në nenin 38 në Statut. Në fokus të kësaj politike qëndron përzgjedhja e një stafi akademik me grada shkencore të larta dhe me eksperiencë në fushën e sistemeve të informacionit dhe inxhinierisë kompjuterike. Kjo politikë është e qartë edhe për stafin akademik me kohë të pjesshme. Në takime u sollën shembuj të statit akademik me kohë të pjesshme (2 pedagoge nga Universiteti i Tiranës) ku ata shprehën edhe pozitivitetin për të punuar pranë UNYT për nivelin e laboratoreve e cila sjell i mundëson ata të konkretizojnë kuadrin teorik të lëndës.</p> <p>UNYT ka të ngritur Zyrën e Burimeve Njerëzore e cila ndjek një procedurë të qartë në 9 hapa për rekrutimin e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Përmbajtja e kontratave të punës ka të specifikuar qartë kohëzgjatjen e punësimit, pagën bruto, ngarkesën mësimore të stafit akademik dhe stafit ndihmës.</p> <p>Programi Bachelor në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit mbulohet në një masë mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë dhe me grada të duhura shkencore (Tabela 5.4).</p> <p>Përsa u përket lëndëve të mbuluara nga stafi akademik, numri i tyre mesatarisht është 3 lëndë për PAE.</p> <p>Për vlerësimin e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme</p>

	<p>është ngritur edhe Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila në bashkëpunim me Departamentin e Informatikës Ekonomike mat performancën e stafit dhe cilësinë e programit të studimit. Forma më e përdorur është shpërndarja e pyetsorit të studentëve në fund të çdo semestri akademik dhe përpunim i të dhënave të tij [takim me NJSBC, dok. 39 – vlerësimi nga studentët]. Vlerësim i stafit të ri bëhet edhe nga stafi senior i cili ndjek praktikën e tutoriatit, hyrjen në mësimdhënie për të siguruar cilësinë e e tij nga stafi i ri [takim me stafin akademik, dok.41: vlerësim nga pedagogët].</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore ka një bazë të dhënash elektronike dhe hard copy për të gjithë procesin e rekrutimit të personelit dhe dokumentacionin përkatës.</p>
--	---

Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor., ose titullin akademik “Docent,,”</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore disponon dokumentacion të qartë, konkret dhe në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e saj të përcaktuara edhe në Statut të UNYT. Dokumentacioni mbahet në formë elektronike dhe në hard copy e cila ruhet edhe në arshivë.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore përditëson të dhënat e stafit akademik dhe personelit ndihmës. Ndryshimi i partnerëve në UNYT ka sjellë edhe një ristrukturim të kësaj zyre.</p> <p>Departamenti i Informatikës Ekonomike, dhe zyra e Burimeve Njerëzore mbajnë të dhëna të qarta në lidhje me listën e plotë të stafit akademik për çdo semestër. Në bashkëpunim me këtë është edhe Sekretaria Mësimore e cila bashkëpunon për të ndihmuar studentët në regjistrimet e tyre në fillim të çdo semestri. Institucioni bën publike njoftimet për rekrutim përmes Zyrës së Burimeve Njerëzore pasi ka marrë memon e brendshme të nënshkruar nga Rektori dhe Shefi i Administratës. Njoftimi bëhet në rrugë elektronike në website të UNYT dhe në median elektronike e të shkruar. Përdoren edhe njoftime në rrjetet sociale për të përthithur kandidaturat më të mira, duke konsideruar që tashmë rrjetet sociale janë më aktive nga komuniteti. Për njoftime përdoren edhe portalet e punësimit.</p> <p>UNYT angazhon kryesisht si titullarë të lëndëve, moduleve personel akademik i cili minimalisht ka gradën shkencore Doktor, por ka dhe raste në të cilën titullari i lëndës ka gradën MSc [dok: syllabuset e lendeve]</p>
---	---

Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale</p>	<p>Në mbështetje të programit mësimor UNYT angazhon edhe një personel ndihmës mësimor. Detyrat e personelit ndihmës janë dhënë edhe në Statut të UNYT, neni 43 dhe 44. Si njësi ndihmës akademike të ngritur në këtë institucion në mbështetje të programit mësimor janë:</p> <p>Zyra e Financës; Sekretaria Mësimore; Zyra e Pranimit të studentëve; Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyra e Menaxhimit të Shërbimeve; Zyra e Menaxhimit të Projekteve; Zyra e kordinimit</p>
--	--

(së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).	<p>SUNY/ESC; Zyra e Mbështetjes me Teknologji Informacioni;</p> <p>Në disa prej tyre si personel janë punësuar studentë të diplomuar nga ky universitet. Kjo është një nga politikat e qarta të institucionit që studentët më të mirë të mund të punësohen në mësimdhënie dhe në personel ndihmës akademik [shembull u dha nga zyra e IT]. Për vitin akademik 2017 – 2018 janë angazhuar 21 dhe për vitin 2018 – 2019 janë angazhuar 20. Ky personel ndihmës jep mbështetje të studentëve në orët laboratorike, në mirëmbajtjen e laboratorëve dhe për këtë të fundit ka një bashkepunim të ngushtë edhe me zyrën e IT-së.</p> <p>Programi mësimor nuk ofron praktika profesionale, ndonëse kjo e fundit u theksua shumë nga studentët dhe stafi akademik.</p>
Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtijshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtijshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>UNYT mbështet stafin akademik dhe kryesisht atë të sapo punësuar për zhvillimin akademik të tyre. Fondet alokohen në lidhje me këtë. Seminare, trajnime dhe ditë të veçanta [dok vizita në institucion, dok 72: Faculty Development Workshop] janë disa nga aktivitete që evidentuam në takimet e kryera dhe në shqyrtimin e dokumentacionit. Të gjitha këto mbështesin përgatitjen akademike të stafit dhe mënyrën e komunikimit të tyre me studentët. UNYT disponon një bazë të dhënash në lidhje me programet që ofrohen. Rregullorja e Programeve të Studimit është një student handbook që jep qartë programin, modulet, rezultatet e pritshme dhe fushat e punësimit të studentëve në fund të diplomit të tyre.</p> <p>Këto të dhëna publikohen edhe në internet në http://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/computer-science/. Verifikimet janë bërë në lidhje me këtë dhe të dhënat janë të aksesueshme .</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p><u>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga takimet e kryera rezulton se:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. UNYT një nga qëllimet bazët të tij ka punësimin e një stafi akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme me eksperiencë dhe me diploma të njohura në vend dhe jashtë. Në fushën e stafit akademik me kohë të pjesshme angazhon edhe pedagogë të huaj (të cilët japin mësim online). 2. UNYT ka të ngritur në strukturën e tij Zyrën e Burimeve Njerëzore e cila disponon një bazë të dhënash të qarta dhe dokumentacionin në formë elektronike dhe në hardcopy për stafin akademik dhe personelin ndihmës të tij. 3. Procedurat e rekrutimit janë të qarta, transparente, jo diskriminuese dhe paragjyquese dhe janë të dhëna qartë edhe në Statut dhe në politikën e punësimit të këtij institucioni; 4. Departamenti i Informatikës Ekonomike jep një mbështetje të zhvillimit dhe trajnimit të stafit akademik me kohë të plotë, ku veçanërisht në fokus janë pedagogët e rinj. 	

4. **Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

UNYT i kushton një vëmendje të veçantë zhvillimit të infrastrukturës mësimore. Kjo është e shprehur edhe në qëllimet e paraqitura në strategjinë e zhvillimit 2018 – 2022. Objekti i UNYT është zhvendosur në 2014 në një godinë të re me 5 kate dhe 2 kate nëntokë dhe në përputhje me të gjithë standartet normative të përcaktuara për një subjekt privat arsimor.

Ndërtesa ka : auditorë për mësim, ambjente të personelit akademik dhe ndihmës mësimor; ambjente laboratorike; ambjente të personelit administrativ; bibliotekë, ambjent për rektorin, senatin akademik dhe shefin e administratës; salle audiovizive, ambjente sportive dhe rekreative etj.

Ndërtesa është e pajisur mirë dhe funksionale. Sallat e leksionit janë të pajisura mirë, me dritë. Ambjentet kanë fluksin e nevojshëm të ndriçimit dhe orientimin e dritës nga e majta sipas projektimit. Sistemi kundra zjarrit është i vendosur në çdo kat dhe skema e evakuimit është e pasqyruar aty. Godina ka ambjent me sistem ngohje qëndrore ku impiantet kryesore janë të vendosur në katin nëntokë në hapësirën e ambjentit teknik. Janë vënë në funksion edhe sistemi gjenerator për të përballuar avaritë në energji elektrike duke siguruar një mirëfunksionim të sistemit të mësimdhënies. Për programin mësimor Bachelor në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit janë në funksion 3 laboratorë që mund të shfrytëzohen për kurse që kërkojnë pajisje kompjuterike si inxhinieri software, bazat e të dhënave dhe rrjetat kompjuterike. Laboratori Nr.1 ka 28 pc, laboratori Nr.2 ka 21 PC dhe laboratori Nr. 3 ka 30 PC. Laboratorët janë pajisur me të gjitha pajisjet dhe një nga laboratorët është e pajisur me të gjithë pajisjet Cisco të nevojshme për zhvillimin e lëndëve që lidhen me rrjetet kompjuterikë. Të gjithë laboratorët e tjerë të kompjuterave kanë pajisje të avancuara që mbështesin platformat e avancuara softuerike, të nevojshme për ofrimin e programit Bachelor.

Në laboratorë ka edhe projektorë për të lehtësuar procesin e mësimdhënies gjatë orëve laboratorike. Në laboratorin nr.3 shumica e pajisjeve janë nga projekt me ERASMUS+. Orët laboratorike kryhen nga lektori. Informacioni në lidhje me zhvillimin e orëve laboratorike jepet në fillim të semestrit dhe në fillim të orës laboratorike. Çdo aspekt teorik konkretizohet qartë në orë laboratorike. Sipas kërkesave të studentëve laboratorët qëndrojnë të hapur edhe ditën e Shtunë dhe të Djelë, ndonëse si evidenca për këtë mund të përmendim takimin me studentët.

Institucioni ofron edhe bibliotekën e cila ka një bazë të gjerë literature. Biblioteka qëndron e hapur në orarin 9.00 -21.30 nga e Hëna deri në Premten, dhe në orarin 9.00-17.00 ditën e Shtunë dhe të Djelë. Tekstet mësimore merren në bazë të nevojave të departamenteve. Për çdo tekst merren 2-3 kopje. Biblioteka përdor sistem katalogimi. Çdo student ka një account statement të cilën e merr tek IT për librat online. Biblioteka ofron edhe revista online. Për librat online ofrohen kryesisht në bazë të marrëveshjes së bërë me Mc Graw Hill. Infrastruktura ofron edhe hapësira rekreative, dhe sportive.

Në aneks (tabela 7) paraqiten në mënyrë të detajuar mjediset për programin e studimit dhe mjediset për stafin.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;	Bazuar mbi shqyrtimin e dokumentacionit dhe vizitën në terren konkludojmë se programi mësimor Bachelor në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit mbështetet mbi një bazë literature detyruese dhe ndihmëse. Për këtë
Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të	

<p>programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>institucioni ofron tekste të cilat janë bashkëkohore. Ofrimi i mësimin në gjuhën angleze përbën edhe një avantazh në shfrytëzimin e një literature koherente me zhvillimet teknologjike pa qenë e nevojshme përkthimi i tyre në gjuhën shqipe. Pasurimi me tekste bëhet mbi bazën e kërkesave që buron nga stafi akademik brenda Departamentit të Informatikës Ekonomike. Mbi bazën e tyre porositen 2-3 kopje të cilat përdoren nga stafi akademik dhe studentët.</p> <p>Biblioteka ka 7320 kopje dhe 7200 tituj librash me një vlerë totale monetare 190,000 euro.</p> <p>Biblioteka ka akses në bibliotek elektronike Jstore, Ebrary, Emerald që nga viti 2002 dhe në vitin 2017 është konkretizuar marrëveshja për bibliotekën online të MC Graw Hill e cila nga stafi akademik konsiderohet si shumë e frytshme për këtë program studimi. Temat e masterit ruhen në vite dhe për këtë përdoren edhe arshiva dixhitale në bibliotekë. Biblioteka ofron edhe një sallë të veçantë për studim dhe është e pajisur me sistem kompjuterik, printer, skaner për të lehtësuar studimin e studentëve dhe përgatitjen e tyre [dok. 28-Biblioteka në UNYT, vizitë në institucion]</p> <p>Institucioni ofron edhe bibliotekën e cila ka një baze të gjerë literature. Biblioteka qëndron e hapur në orarin 9.00 -21.30 nga e Hena deri të Premten, dhe në orarin 9.00-17.00 ditën e Shtunë dhe të Djelë [dok.29 – Evidencë Infrastrukturë].</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhinieri, ekonomi, mjekësi, programstimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>UNYT ofron një godinë me 5 kate dhe 2 kate parkim nëntokë për të gjithë programet e studimit ku futet edhe programi Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit. Godina është e ndërtuar në përputhje me normat e ndërtimit dhe shfrytëzimit dhe e pajisur sipas standarteve që kërkohet për një institucion privat arsimor. Sallat e leksioneve dhe laboratorë janë të pajisur me të gjithë pajisjet që kërkohen për një program studimi. Dokumentacioni i dorëzuar dhe verifikimet e bëra gjatë vizitës në insitution dhe dëshmojnë për cilësinë e pajisjeve që ofrohen në mësimdhënie. Për këtë program studimi ofrohen 3 laboratorë të cilat janë të pajisur me të gjithë programet dhe pajisjet e duhura për të mbështetur temat teorike që ofrohen në këtë program studimi. Për mirëmbajtjen e tyre është edhe qëndra e IT ky 2 prej punonjësve kanë qenë studentë të diplomuar në këtë universitet për inxhinieri kompjuterike. I gjithë programi mbështetet nga infrastruktura dhe laboratorët që vetë institucioni zotëron.</p>
<p>Konkluzione të GVJ:</p> <p>1- UNYT zotëron infrastrukturën e duhur për ti dhënë mbështetje procesit mësimor.</p>	

- 2- UNYT për këtë program studimi ofron salla leksioni, laboratorë , hapësira rekreative për studentët në përputhje me stadartet e kërkuara.
- 3- UNYT zotëron 3 salla laboratorikë ku zhvillohen orët e praktikës dhe shërbejnë edhe për mësim online me pedagogët e huaj (për diplomat e dyfishta).
- 4- UNYT ndjek një procedurë dhe politikë të qartë për pasurimin e bibliotekës. Ajo përmban një literaturë të gjerë dhe pasurohet çdo vit sipas kërkesave të paraqitur nga departamenti dhe stafi akademik. Ofrimi i leksioneve në gjuhën angleze përben lehtësi në sigurimin e literaturës bashkëkohore për këtë fushë studimi.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

UNYT përdor mekanizma të duhur për kontrollin dhe menaxhimin e të ardhurave. Në Statut në nenin 32 të saj janë përcaktuar qartë kompetencat e Bordit të Administrimit i cili si Organ kolegjal i këtij institucioni në detyrat e tij ka të përcaktuar qartë edhe mbarëvajtjen financiare dhe administrative të UNYT. Bordi i Administrimit përbëhet nga shtatë anëtarë:

1. Përfaqësusi ligjor/Administrator i Shoqërisë Themeluese;

Përfaqësuesi i Ortakëve - Përfaqësues i zgjedhur nga Senati Akademik

- Dy Përfaqësues të administratës së UNYT
- Ekspert ligjor në fushën e arsimit të lartë
- Ekspert për taksat dhe tatimet

Në varësi të tij dhe Rektorit të UNYT është ngritur zyra e Financës e cila është e ngarkuar me zbatimin e politikës financiare institucionale. Kjo zyrë ka tre ekspertë finance dhe mbikqyret nga drejtori i saj i cili raporton në Bordin e Administrimit.

Për studimin e politikës së menaxhimit të të ardhurave u mbështetëm në të dhënat e paraqitura nga institucioni dhe nga RBV. Shumë pyetje u drejtuan në lidhje me fondet e alokuara për infrastrukturë, staf akademik, mobilitet të studentëve, pasurimin e bibliotekës për të përcaktuar qartë që të dhënat e deklaruara në RVB dhe në anekse janë në përputhje me situatën reale për këtë program studimi [**Aneksi 31: Internal Audit 2012 – 2013; Aneksi 32: External audit 2017; Aneks 33: RRPP Financial Review Report; Aneks 34: Raporti Vjetor 2017 – 2018: Pjesa Financiare; Aneks 35: Internal Finance Audit Report 2015 – 2016; Aneks 36: Sqarim Pasqyra Financiare 2018**];

Burimet financiare të universitetit janë kryesisht nga tarifat e shkollimit. Të gjitha këto të ardhura shkojnë për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e strukturave menaxhuese.

Në fund të çdo viti akademik UNYT kryen analizën e të ardhurave dhe të kostove të programeve të studimit. Analiza e kostove përmban:

- Kosto operative, kosto të blerjes së aseteve të trupëzuara apo të patrupëzuara të nevojshme për funksionimin e aktivitetit të UNYT dhe
- kosto për blerje të liçensave të programeve software, liçensave të bibliotekave elektronike, etj.

Analiza e kostos e programeve shoqërohet edhe me të ardhurat që gjenerohen nga çdo program. UNYT kryen auditime të brendshme dhe të jashtme në baza vjetore.

Në mënyrë të përmbledhur për 6 vitet e fundit këto të ardhura paraqiten në tabelën 8.1 në aneks, ndërsa të shprehura në përqindje sipas burimeve të të ardhurave paraqiten në tabelën në vijim:

Të ardhurat nga:	Viti 2012 (%)	Viti 2013 (%)	Viti 2014 (%)	Viti 2015 (%)	Viti 2016 (%)	Viti 2017 (%)
Grantet për kërkim dhe kontratat	0.7	0.1	0.7	4.4	4.6	5.5
Tarifat për dhe gjatë shkollimit	98.9	99.6	99.0	95.0	95.1	94.5
Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)	0.4	0.4	0.3	0.7	0.3	0.0
<i>SHUMA</i>	100	100	100	100	100	100

Për sa u theksua edhe më sipër burimi kryesor i financimit janë të ardhurat që gjenerohen nga studentët. Tarifa për vitin financiar 2017 – 2018 për Programet Bachelor - 4 vjeçar janë specifikuar në pasqyrat financiare të paraqitura nga Institucioni. Nga të dhënat e tabelës më sipërm evidentojmë një luhajtje të të ardhurave nga grantet dhe kërkim. Mesatarisht për periudhën 2012 – 2017 këto luhën në 2.67%. Tarifat për shkollim është burimi kryesor financiar. Në periudhën 2012-2014 këto zënë 99% dhe vëme re një rënie të tyre për vitet në vijim. Nuk ka të ardhura që gjenerohen nga aktivitetet tregtare.

Në se i referohemi tabelës 8.2 në aneks, vërehet se rreth 45-55% e të ardhurave i dedikohen pagave, pjesa tjetër, rreth 41-49% shpenzimeve operative, ndërsa investimet shifrohen në më pak se 10% (maksimumi prej 10 % i korrespondon transferimit të UNYT në ambientet aktuale).

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>UNYT ka të ngritur organet kolegjiale të cilat hartojnë politikat dhe garantojnë zbatimin dhe menaxhimin efikas të tyre. Për të siguruar një mirëpërdorim të të ardhurave institucioni ndërmerr auditime të brendshme dhe të jashtme. Auditimet e brendshme realizohen edhe si pasoje e ndjekjes së politikës së bashkëpunimit me partneret e huaj. Kryesisht auditimi i brendshëm kryhet nga një Komision i Emëruar nga Bordi i Administrimit [Neni 33 ne Statut]. Për vitet e fundit UNYT ka angazhuar edhe kompani të jashtme auditimi të cilat ofrojnë edhe rekomandimet e nevojshme për ruajtjen e asetëve dhe forcimin e qëndrueshmërisë financiare të institucionit [Aneksi 31: Internal Audit 2012 – 2013; Aneksi 32: External audit 2017; Aneks 33: RRPP Financial Revie Report; Aneks 34: Raporti Vjetor 2017 – 2018: Pjesa Financiare; Aneks 35: Internal Finance Audit Report 2015 – 2016; Aneks 36: Sqarim Pasqyra Financiare 2018];</p>
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose</p>	<p>Në fund të çdo viti akademik UNYT kryen analizën e të ardhurave dhe të kostove të programeve të studimit. Analiza e kostove</p>

ndarjen e burimeve financiare;

Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;

Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.

përmban:

- Kosto operative: kosto e mësimdhenies, udhëtimi dhe akomodimi e profesorëve që udhëtojnë nga jashtë vendit, tarifat që u paguhen universiteteve partnere (State University of New York/ Empire State College; University of Greenwich,), pagat e stafit mbështetës administrativ sikurse dhe kosto te tjera fikse operacionale sikurse qera, energji /telefon/ internet etj të cilat janë të lidhura me këto programe
- Kosto të blerjes së aseteve të trupëzuara apo të patrupëzuara të nevojshme për funksionimin e aktivitetit të UNYT
- Kosto për blerje të licensave të programeve softëare, licensave të bibliotekave elektronike, etj.

Analiza e koston e programeve shoqërohet edhe me të ardhurat që gjenerohen nga çdo program. Një analizë fitim/humbje bëhet për programet bachelor në përgjithësi sikurse dhe çdo program M.SH. dhe PhD në veçanti dhe bëhen modifikimet e nevojshme të komponenteve të caktuar të koston për vitin e ardhshëm akademik.

Nga dokumentacioni i dorëzuar nuk kemi informacion të qartë në lidhje me analizën kosto/humbje për programin e studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me Profil Sistemet e Informacionit. Numri i pakët i studentëve dhe stafi i angazhuar për këtë program studimi sjell në llogjike konkludimin që ky program studimi nuk mbulon koston e tij, por nga takimet e kryera me Zv. Rektoren, Dekanin e Fakultetit të Informatikës, Shefin e Departamentit, u theksua qëndrueshmëria financiare dhe kjo përforcohet me tej me ardhjen e partnerëve të rinj në këtë universitet të cilët në synimet e tyre afatgjatë kanë investime të mëtejshme në infrastrukturë dhe garantimin e një qëndrueshmërie financiare.

Në tërësinë e tij UNYT garanton një qëndrueshmëri financiare. Vendosija e partnereve të rinj në administrimin e këtij institucioni është tregues i soliditetit financiar të institucionit.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. UNYT ka të ngritur Bordin e Administrimit për hartimin e politikave financiare dhe Zyrën e Financës për menaxhimin dhe zbatimin e këtyre politikave.
2. UNYT mbështetet financiarisht nga të ardhurat që gjenerohen nga studentët. Të ardhurat për grantet ndonëse në vitet e fundit kanë filluar të kenë rritje nuk janë mjaftueshëm për të dhënë impakt në aspektin financiar.
3. UNYT ndjek një procedurë të qartë për hartimin e buxhetit financiar ndonëse nuk kemi të dhëna për pjesëmarrje e stafit akademik në të.
4. UNYT në fund të vitit akademik në raportin e tij vjetor ka të përfshirë edhe analizën humbje/fitim, ku rekomandojmë që këto analiza të jenë të specifikuar për programet në veçanti.
5. Konstatohet qëndrueshmëri financiare e UNYT, por eventualisht mund të punohej në drejtim të diversifikimit të burimeve të financimit.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Cilësia është në qendër të të gjitha aktiviteteve të UNYT. Kjo shprehet në misionin dhe objektivat e universitetit dhe në objektivat e programit të studimit. Në qendër të tyre është ofrimi i një programi studimi në përputhje me standartet e cilësisë së Arsimit të Lartë në Shqipëri përmes zbatimit të praktikave fleksibël dhe inovative në mësimdhënie.

Kuadri ligjor që përcakton këto procedura bazohet në:

- Standardet Shtetërore të Sigurimit të Cilësisë për vlerësimet e programeve institucionale dhe studimore 2;
- Rregulloret e sigurimit të cilësisë;
- Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Zonën e Arsimit të Lartë Evropian (ESG) (miratuar nga Konferenca Ministrore në Maj 2015)

Sigurimi i cilësisë në këtë universitet garantohet nga mekanizmat e ngritur brenda institucionit dhe rregullohet dhe kontrollohet nga ASCAL dhe Bordi i Akreditimit si organe të jashtme të cilat shqyrtojnë të gjitha aspektet e institucioneve të arsimit të lartë në nivel kombëtar.

Sigurimi i Cilësisë brenda UNYT administrohet nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit, me mbështetjen e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë.

Të gjitha procedurat e Sigurimit të Cilësisë rishikohen në periudha të rregullta dhe të gjitha rezultatet e performancës me propozimet përkatëse i dorëzohen Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe Senatit nëse ka nevojë për ndryshime institucionale në politikat dhe praktikat e miratuara.

Rishikimet bëhen për çdo vit akademik bazuar në kërkesat e partnerëve vendas dhe ndërkombëtarë. UNYT ka hartuar edhe Dokumentin e Manualit të Sigurimit të Cilësisë i cili rishikohet në mënyrë periodike.

Të gjitha informatat në lidhje me politikat dhe praktikat që lidhen me sigurimin e cilësisë në UNYT janë të arritshme për të gjitha grupet dhe njësitë e interesuara duke përfshirë trupat e studentëve.

Në funksion të garantimit të cilësisë në programet e studimit është ngritur Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit (PCAQSI- KPSSCI) i përbërë nga 5 anëtarë dhe që zgjidhet nga Senati Akademik me misionin e zhvillimit dhe forcimit të sistemit të cilësisë në UNYT për t'i shërbyer nevojave të bashkësisë universitare dhe organeve të tjera të interesuara që lidhen me cilësinë e institucionit dhe të programeve të studimit të ofruara nga UNYT.

Ky komision është përgjegjës për koordinimin e procedurave të vlerësimit të njësive akademike të brendshme dhe të jashtme, kërkimeve shkencore dhe vetë universitetit. KPSSCI mbikqyr dhe zhvillon rregulloret, politikat, programet, proceset akademike dhe jo akademike dhe siguron përputhjen me kuadrin ligjor që siguron cilësi në UNYT në bashkëpunim me të gjithë aktorët.

Vlerësimi i brendshëm i strukturave dhe programeve të studimit kryhet periodikisht sipas dispozitave të Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë. Në funksion të këtij Komisioni është ngritur edhe Zyra për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë e cila implementon politikat në lidhje me garantimin e cilësisë dhe harton raporte për aktivitetet dhe iniciativat e reja që lidhen me sigurimin e cilësisë për të gjitha njësitë e UNYT përmes Koordinatorit të Sigurimit të Cilësisë. Funksionimi i PCAQSI është i rregulluar nga Doracak i Sigurimit të Cilësisë i hartuar dhe miratuar nga vetë Komisioni në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë.

PCAQSI koordinon, përpilon dhe raporton aktivitete dhe iniciativa të reja lidhur me sigurimin e cilësisë në të gjitha njësitë e UNYT nëpërmjet njësisë së Sigurimit të Cilësisë dhe Koordinatorit të saj. Funksionet e KPSSCI rregullohen nga Manuali i Sigurimit të Cilësisë i hartuar dhe miratuar nga Komisioni. Në

përputhje me udhëzimet kombëtare për sigurimin e brendshëm të cilësisë, përgjegjësitë kryesore të KPSSCI lidhen me:

- Hartimi i një raporti vjetor të vetëvlerësimit (institucional dhe programeve);
- Promovimi dhe nxitja e vetëdijes së brendshme për të gjitha njësitë për çështjet e cilësisë;
- Krijimi i besueshmërisë për vlerësimin e jashtëm për të gjithë aktorët;
- Ofrimi i asistencës dhe informacioni i azhurnuar mbi çështjet e sigurimit të cilësisë që i përmbahen kërkesave të reja ligjore.

Të gjitha procedurat e Sigurimit të Cilësisë rishikohen në periudha të rregullta dhe të gjitha rezultatet e performancës me propozimet përkatëse i dorëzohen Komisionit të Përherëshëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe Senatit nëse ka nevojë për ndryshime institucionale në politikat dhe praktikat e miratuara.

Në mbështetje të procesit të sigurimit të cilësisë ka qenë dhe pjesëmarrja e UNYT si partner në projektin Erasmus +: QainAL -"Mbështetje Strategjike për Forcimin e Strukturave të Sigurimit të Cilësisë në Institucionet Private të Arsimit të Lartë në Shqipëri", projekt i cili fokusohet në krijimin dhe mbështetjen e proceseve për sigurimin e cilësisë dhe mekanizmave për sigurimin e menaxhimit efektiv dhe përmirësimin e mësimdhënies dhe të nxëniet në institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri. Angazhimi në këtë projekt dhe trajnimet e marra, i kanë shërbyer UNYT në përmirësimin e praktikave të sigurimit të cilësisë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit

Zyra e Sigurimit të Cilësisë është përgjegjëse për implementimin e anketimeve tek studentët në lidhje me matjen e performancës dhe cilësisë së programit të studimit. Këto anketime kryhen dy herë në vit (në fund të çdo semestri). Pyetësorët shpërndahen në formë hard copy dhe plotësohen në mënyrë anonime nga studentët. Tabela në aneks jep edhe numrin e studentëve pjesëmarrës në anketim. Evidentojmë masën mbi 90% të pjesëmarrjes së studentëve në këtë procedurë.

Përpunimi i të dhënave bëhet përmes programeve dhe finalizohen në një raport përfundimtar. Rezultatet e anketimeve paraqiten tek stafi akademik dhe Përgjegjësi i Departamentit. Një raport përfundimtar paraqitet edhe në Senat i cili ndërmerr edhe përmirësimet e duhura në bazë të problematikës dhe rekomandimeve përkatëse të paqyruara në raport.

Forma të tjera vlerësimi janë:

- Formulari i rishikimi të syllabusit;
- Formulari vlerësimi nga stafi akademik (Peer Evaluation of Teaching)
- Matja e performancës së stafit akademik nga departamenti përmes plotësimit të formularit nga stafi akademik dhe analizimit të tij në fund të vitit. Rezultatet e tij pasqyrohen edhe në Raportin Vjetor të Monitorimit në Departament.
- Formularët për Kontrollin e Sigurimit të Cilësisë së Vlerësimit, Transparenca, Krahasueshmëria dhe Auditimi të cilat kryhen një herë në semestër, gjatë 3-4 javëve të para të një semestri pasues. Shefi i Departamentit zgjedh në mënyrë rastësore klasa për të shqyrtuar gjetjet gjatë semestrit dhe vlerësimin e tyre. Për programin e studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me Profil Sistemet e Informacionit për vitin akademik 2017 – 2018 janë marrë në shqyrtim 12 module të ofruara nga staf akademik i brendshëm.

Të gjithë të dhënat e mbledhura nga pyetësorët përpunohen dhe nga analiza e tyre ka rezultuar se, në përgjithësi, studentët janë shprehur pozitivisht. Rezultatet e anketimeve dhe të formularëve i paraqiten

stafit akademik. Shembuj realë u sollën edhe gjatë takimit me anëtarë të NJSBC të cilët treguan shembull vetjake të vlerësimit të tyre. NJSBC harton një raport vjetor dhe rezultatet i paraqiten Senatit Akademik i cili ndërmerr edhe masat në lidhje me rekomandimet e dhëna. Raporti vjetor hartohet edhe nga Përgjegjësi i Departamentit në lidhje me aktivitetin e departamentit mbi bazën e objektivave të vendosura nga stafi akademik dhe përmbushjen e tyre në fund të vitit akademik. Ky raport shoqërohet edhe me një analizë SWOT [dok. 59 Annual Monitoring Report 2017-2018].

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

UNYT i kushton një vëmendje të veçantë sigurimit të cilësisë për programet e studimit që ofron. Në lidhje me këtë duhet të pranojmë që ky universitet ka qenë pionier në zbatimin e formave dhe metodave të matjes së performances akademike. Zyra e NJSBC është në varësi të Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë të Institucionit dhe në varësi të Rektorit. Zyra e NJSBC është ngritur për të zbatuar politikën institucionale për sigurimin e cilësisë. Në punën e tyre ndikon edhe bashkëpunimi me partnerët e huaj të cilët sjellin edhe format më bashkëkohore në këtë drejtim. Nga shyrtimi i dokumentacionit dhe takimet e kryera konkludojmë që kjo zyrë është aktive. Anëtarësia e saj përbëhet nga 5 anëtarë staf akademik i brendshëm, 1 student dhe 1 anëtar si ekspert i jashtëm. Roli i NJSBC konsiston në:

1. Puna për të përthithur sa më mirë feedback nga studentët në lidhje me programin e studimit përmes shpërndarjes së pyetsorëve në fund të çdo semestri akademik;
2. Bashkëpunimi me Zyrën e Karrierës & Alumni për të mbledhur informacion që i shërben përmirësimit të programit të studimit dhe për të qenë më koherentë me zhvillimet dhe kërkesat e tregut të punës;
3. Kontrolle periodike në bashkëpunim me Shefin e Departamentit me fokus në:
 - a. Përmirësimin e syllabuseve;
 - b. Kontrollin e syllabuseve përmes vlerësimit të marrë nga studentët në lidhje me përmbajtjen e tij dhe mënyrën e organizimit të tij;
 - c. Kontrollin e mënyrës së organizimit të provimit, kontrollit të tyre, vlerësimit në notë;
 - d. Bashkëpunon me Sekretarinë Mësimore për të garantuar transparencë në hedhjen e notave dhe paraqitjen e tyre tek studenti brenda afateve të përcaktuara në rregullore;
4. Zbaton Manualin e Sigurimit të Cilësisë. Në lidhje me këtë bashkëpunon ngushtë me Komisionin e Kurrikulave për të rekomanduar edhe përmirësimet e duhura;
5. Siguron implementimin e politikave dhe rekomandimeve të dhëna nga Agjensi të Sigurimit të Cilësisë si ASCAL dhe udhëzimet e dhëna nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë;
7. Kontribuon në njohjen e stafit të ri me metodologjinë e mësimdhënies (organizim seminaresh);
8. Kontribuon në rishikimin e pyetsorëve;
9. Hartimin e një raporti semestral e vjetor të aktivitetit.

Të dhënat e mbledhura transferohen tek stafi akademik, shefi i departamentit dhe janë të aksesueshme.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

NJSBC bashkëpunon ngushtë në lidhje me garantimin e sigurimit të cilësisë së programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me Profil Sistemet e Informacionit. Në lidhje me këtë në monitorimin e menaxhimin të cilësisë një rol të rëndësishëm luajnë edhe partnerët e huaj kryesisht SUNY – ESC

University (për diplomë të dyfishtë) të cilët kryejnë auditime periodike dhe janë koherent në lidhje me çdo ndryshim në program. Syllabuset për këtë program studimi (për diplomën e dyfishtë) janë të unifikuara dhe ndryshimet bëhen në diskutim me këtë universitet [Aneks 24.2: Audit i ESC për kurrikulën e Shkenca Kompjuterike me Profil Sistemet e Informacionit].

Bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm dhe në gjëndjen e konstatuar gjatë vizitës, UNYT ka politika të qarta të vlerësimit të mbështetura në standartet e cilësisë. Nuk u evidentuan ndryshime ndërmjet të dhënave të deklaruara dhe atyre të konstatuara.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standartet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; c. Pyetje konceptuale; d. Intervista; e. Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); b. Dëgjime në auditor; c. Vlerësimi me nota/pikë; d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet); f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; g. Etj. 	<p>UNYT ka të institucionalizuar sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Për këtë shërben Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë të Institucionit dhe zyra e NJSBC. Roli i tyre është i rëndësishëm në hartimin e politikave për cilësinë dhe zbatimin e tyre nga Departamenti. Të dy këto njësi janë përgjegjës për përzgjedhjen e metodave të matjes së cilësisë dhe përgatitjen e raporteve dhe rekomandimeve përkatëse. Si metoda të drejtpërdrejta përdoren:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetsor për studentët; - Formulari i rishikimi të syllabusit; - Formulari i vlerësimit nga stafi akademik (Peer Evaluation of Teaching) - Matja e performancës së stafit akademik nga departamenti përmes plotësimit të formularit nga stafi akademik dhe analizimit të tij në fund të vitit. Rezultatet e tij pasqyrohen edhe në Raportin Vjetor të Monitorimit në Departament. - Formularët për Kontrolllet e Sigurimit të Cilësisë së Vlerësimit, Transparenca, Krahasueshmëria dhe Auditimi të cilat kryhen një herë në semestër, gjatë 3-4 javëve të para të një semestri pasues. Shefi i Departamentit zgjedh në mënyrë rastësore klasa për të shqyrtuar gjetjen gjatë semestrit dhe vlerësimin e tyre. Për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike me Profil Sistemet e Informacionit për vitin akademik 2017 – 2018 janë marrë në shqyrtim 12 module të ofruara nga stafi akademik i brendshëm. <p>B. Metoda të drejtpërdrejta:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i pjesëmarrjes së studentit në orët e mësimit; • Vlerësimi i detyrave të realizuara nga studenti; <p>Të dhënat e mbledhura përpunohen në formë të raporteve</p>

	<p>vjetore dhe shoqërohen me analizë dhe rekomandime përkatëse.</p> <p>Në sigurimin e cilësisë për programin e studimit një rol të rëndësishëm luan edhe universiteti SUNY – ESC (për diplomë të dyfishtë) të cilët kryejnë auditime periodike dhe janë koherent në lidhje me çdo ndryshim në program.</p>
VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>UNYT është akredituar institucionalisht për herë të parë në vitin 2006 dhe u riakreditua në nivel institucional në vitin 2015.</p> <p>Gjithashtu UNYT u riakreditua institucionalisht në kuadër të bashkëpunimit të ASCAL me Agjensinë Britanike QAA me vendim Bordit të Akreditimit Nr. 102, dt.10.11.2017.</p> <p>UNYT ka ngritur Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë të Institucionit dhe zyra e NJSBC, dy njësi këto të cilat formulojnë politikat për sigurimin e cilësisë dhe janë përgjegjëse për implementin e tyre në të gjithë hallkat e institucionit.</p> <p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë së Institucionit bashkërendon punën e tij me Rektorin e UNYT dhe Senatin akademik për hartimin e politikave të duhura dhe përmirësimet e nevojshme në lidhje me garantimin e sigurimit të cilësisë në institucion. Metodrat dhe mjetet e zbatimit të tyre nga NJSBC janë të përcaktuara qartë në Manualin e Sigurimit të Cilësisë. NJSBC është përgjegjëse për përmirësimin e vazhdueshëm të formave të matjes së cilësisë së programit të studimit. Në këtë drejtim një rol të rëndësishëm luajnë edhe auditimet nga partnerët e huaj (për diplomë të dyfishtë).</p> <p>Format e përdorur nga NJSBC për matjen dhe garantimin e cilësisë ndërmerren në bashkëpunim me Shefin e Departamentit dhe rezultatet janë të aksesueshëm. Procedurat dhe modelet e vlerësimit të aplikuar për këtë program studimi janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Formulari i Performancës së Vlerësimit Individual; 2. Raporti i Paanshmërisë, Transparencës, Krahasueshmërisë dhe Auditimit; 3. Formulari i vlerësimit të studentëve; 4. Raporti vjetor i departamentit; 5. Formularë të vlerësimit të kolegëve (peer evaluation form); <p>Institucioni i kushton një vëmendje të veçantë ndërgjegjësimit të stafit akademik dhe studentëve në lidhje me rëndësinë e sigurimit të cilësisë. Numri i studentëve pjesëmarrës në</p>

W

RF

anketime është rritur në vite. Takimi me studentët evidentoi rolin aktiv të tyre në këtë proces dhe shprehjen e lirë të mendimit të tyre në lidhje me çdo syllabus.

Politikat për sigurimin e cilësisë i gjejmë të inkorporuar në 7 qëllimet bazë të strategjisë të zhvillimit të UNYT për periudhën 2018-2022.

Konkluzionet e vlerësimit:

- UNYT është ri-akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për riakreditimin e programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me Profil Sistemet e Informacionit.
- UNYT ka të ngritur një strukturë solide dhe gjithpërfshirëse që garanton sigurimin e cilësisë së mësimdhënies në programin e studimit. UNYT ka ngritur Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë të Institucionit dhe zyra e NJSBC përgjegjëse për hartimin e politikave dhe zbatimin e tyre në programet e studimit.
- Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë të inkorporuar në Strategjinë e Zhvillimit 2018-2022 dhe roli, detyrat dhe funksionet e KPSSCI dhe NJSBC janë të shprehur qartë në Statut.
- UNYT ndjek një politikë të qartë në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e programit të studimit. Manuali i Sigurimit të Cilësisë siguron të gjithë procedurat dhe metodologjitë në lidhje me vlerësimin në nivel institucional dhe program studimi.
- Sigurimi i cilësisë në këtë universitet garantohej nga mekanizmat e ngritur brenda institucionit dhe rregullohet dhe kontrollohet nga ASCAL dhe Bordi i Akreditimit si organe të jashtme të cilat shqyrtojnë të gjitha aspektet e institucioneve të arsimit të lartë në nivel kombëtar.

Programi i studimeve BSc. në Shkenca Kompjuterike, me profil “Sistemet e Informacionit” është në monitorim të vazhdueshëm të cilësisë edhe nga SUNY-ESC dhe punohet mbi bazën e kurrikulave dhe syllabuseve të unifikuara.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Programi i Studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike, me Profil Sistemet e Informacionit u hap në vitin 2002. Ky program u liçensua në 15.08.2002 përmes VKM nr.397. Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me Profil Sistemet e Informacionit realizohet me së paku 128 kredite amerikane ekuivalente me 256 kredite ECTS. Kohëzgjatja e programit të studimit është 4 vjet me një mesatare prej 64 ECTS/vit akademik. Ky program studimi synon që studenti në fund të studimeve të tij të këtë përfutur një kuadër teorik dhe praktik të nevojshëm për punësim të tij në tregun e punës në Shqipëri dhe jashtë vendit. Programi i studimit ofron diplomë të dyfishtë në bashkëpunim me Universitetin SUNY – ESC (SHBA).

Pas përfundimit me sukses të këtij programi studimi [aneksi 3: Rregullore e Programeve Bachelor 2017-2020] studentët do të janë përgatitur për:

- Të demonstruar njohuri të thella të një shumëllojshmërie konceptesh, teorish dhe aplikimesh të sistemeve informatike dhe informative, me aftësi për të ushtruar gjykime kritike në një sërë çështjesh.

- Të demonstrojnë njohuritë themelore, kuptojnë, analizojnë dhe aplikojnë në mënyrë kritike koncepte, parime dhe praktika thelbësore në kontekstin e skenarëve, duke treguar gjykimin në përzgjedhjen dhe aplikimin e mjeteve.
- Të prodhojnë punë që përfshin identifikimin e problemeve, analizën, dizajnimin dhe zhvillimin e një sistemi softueri, zgjidhjen e problemeve dhe aftësitë e vlerësimit të cilësisë.
- Të kenë aftësinë për të punuar si individ nën udhëzime ose me udhëzime minimale dhe si drejtues të punës në grup.
- Të jenë të aftë të identifikojnë dhe të zhvillojnë mekanizma për progres të vazhdueshëm profesional dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.
- Të identifikojnë dhe ndjekin praktika të përshtatshme brenda kuadrit profesional, ligjor dhe etik.

Në fund të studimeve të tyre ky program studimi krijon mundësi punimimi si analist të sistemeve të informacionit, specialist databazash për sisteme të informacionit, zhvillues sistemesh.

Ky program ofron studime të thelluara në nivelin Master i Shkencave.

Kurrikulat janë hartuar në bazë të eksperiencës akademike dhe profesionale të stafit akademik, përvojës së studentëve të diplomuar. Për diplomë të dyfishtë është marrë edhe konsulenca e partnerëve të huaj të cilët në mënyrë të vazhdueshme monitorojnë programin e studimit dhe janë pjesë e vendimarrjes për ndryshimet përkatëse në të.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit ofrohet në bashkëpunim me Universitetin Shtetëror të New York-ut, Empire State College, (SUNY-ESC) New York, SHBA)

Objektivat e programit të studimit janë krijimi i specialistëve të sistemeve të informacionit me njohuri mbi:

- a. teorinë bazë të komputacionit dhe të algoritmave;
- b. aftësi mbi programimin,
- c. aftësimi mbi bazën e të dhënave;
- d. inxhinierinë software;
- e. njohuri në kontabilitet, financë dhe menaxhim;

Ky objekti është i zbërthyer në tre objektiva bazë për këtë program studimi:

1. Të kuptojë procesin e analizimit, projektimit dhe zhvillimit të sistemeve të informacionit bazuar në software për probleme komplekse;
2. Të jetë kompetent në menaxhimin e sistemeve të informacionit dhe në mirëmbajtjen e tyre me synimin përfundimtar të optimizimit të procesit të vendimarrjes;
3. Të jetë kompetent në realizimin me sukses të zgjidhjeve praktike që kanë të bëjnë me implementim sistemesh informative bazuar në software, ndërtim dhe manipulim databazash, ndërtim dhe menaxhim rrjetesh për ngritjen e infrastrukturës bazë të një sistemi informativ;

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Programi zhvillohet me një kohëzgjatje prej katër vitesh dhe organizohet si më poshtë:

- Semestri i parë fillon në Tetor të çdo viti dhe përfundon në fund të Shkurtit.
- Semestri i dytë fillon në Mars deri në muajin Qershor.
- Semestri veror zgjat një muaj në Korrik.

Organizimi i programit:

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore = 60 minuta

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Tabela 10 në aneks paraqet planin mësimor për të katër vitet akademike. Bazuar edhe në aneks 2.3- Tabela e organizimit të programit të studimit, kemi bërë konvertimin nga kredite amerikane në ECTS (1 kredit = 2 ECTS). Referuar këtij plani studenti duhet të realizojë në total 256 ECTS të cilat shpërndahen sipas viteve si vijon:

- Viti I : 60 ECTS (26 ECTS në semestrin e I dhe 34 ECTS në semestrin II)
- Viti II: 64 ECTS (32 ECTS në semestrin e I dhe 32 ECTS në semestrin II)
- Viti III: 66 ECTS (32 ECTS në semestrin e I dhe 34 ECTS në semestrin II)
- Viti IV: 66 ECTS (34 ECTS në semestrin e I dhe 32 ECTS në semestrin II)

Në këtë program studim studentit është i lirë të bëjë zgjedhje të lëndëve nën këshillimin e një këshilluesi. Ai mund të zgjedhë vetë lëndet për çdo vit akademik, por të ketë kaluar lëndët me parakusht ("prerequisites"). Kjo mund të sjellë edhe në zgjatje të studimeve me shumë se 4 vjet por progresi i tij bëhet mbi bazën e rezultateve të marra në vit akademik dhe mundëson një përfitim më të mirë të njohurive në përputhje me mundësitë potenciale që ai zotëron.

Në fillim të semestrit studentit bën regjistrimin e lëndëve, por eventualisht mund të tërhiqet nga një (apo më shumë) lëndë brenda javës së parë të semestrit përkatës të fillimit të zhvillimit të lëndës.

Tabela 11 në aneks paraqet planin mësimor të ndarë sipas veprimtarive formuese. Duke ju referuar kësaj tabele në trajtë të përmbledhur kemi elementët në vijim të veprimtarive formuese të ballafaquara me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018:

Kategoria	Sipas VKM Nr. 41, datë 24.1.2018		Programi i studimeve Bachelor në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit
	Tipi i komponentit mësimor	Cikli Bachelor	
A	LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme	15% - 20% (kredite)	18.75%
B	LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disipinën shkencore	50% - 55% (kredite)	45.31%
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje	12% -15% (kredite)	16.4%
D	LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale	10-15% (kredite)	16.4%

E	DETYRIME PËRMBYLLËSE - diploma	3%-5% (kredite)	3.2%
---	---	--------------------	------

Ndonëse kategoria A: Lëndë Bazë përmban përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme evidentojmë që 18.75% e tij i përkasin formimit në lëndë si Art Course, US History etj. Në takimin e zhvilluar u sqarua që kjo është e kërkuar edhe nga partnerët e huaj si pasoje e ofrimit të një diplome të dyfishtë.

Kategoria B: Lëndë Karakterizuese zë 45.31 % dhe mendojmë se ndonëse është brenda kufirit të lejuar të VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 duhet të zgjerohet më tej në këtë disipline që do të mundësojnë një formim në spekter më të gjerë të studentit në këtë fushë.

Në këtë program nuk ofrohen praktika profesionale dhe bazuar edhe në mendimin e studentëve rekomandojmë një vendosje të tij ç'ka do të mundësojë një aftësim më të mirë në fushën e praktikës të studentëve në fund të studimeve të tyre.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

Shyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga UNYT [aneks 2.2 – Syllabuset e lëndëve; aneks 2.3- Tabela e organizimit të programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me Profil Sistemet e Informacionit] dhe takimet e zhvilluara me studentë dhe stafin akademik konkludojnë në një inkorporim integral të orëve të leksionit, seminareve dhe orëve laboratorike. Këto komponente zhvillohen së bashku dhe konsiderohen pjesë e leksionit.

Leksionet 45 orë në auditor dhe 105 orë punë e pavarur e studentit për lëndët të barazvlefshme me 3 kredite amerikane ose 6 ECTS.

- Leksionet 60 orë në auditor dhe 140 orë punë e pavarur e studentit për lëndët të barazvlefshme me 4 kredite amerikane ose 8 ECTS.

Sipas kësaj skeme koha e punës në auditor përbën vetëm 30% të kohës totale të punës për realizimin e një krediti ECTS.

Duke ju referuar VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve, që ka secila disiplinë. Në këtë aspekt do të duhej të specifikoheshin në planin mësimor të gjithë këta elementë me qëllim që të mund të gjykohej edhe për raportet eventuale.

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Tabela 12)

Tabela 12 në aneks paraqet ndryshimet e planit mësimor të vitit akademik 2018-2019 me planin mësimor që i korrespondojnë akreditimit të vitit 2013. Në total, 4 lëndë janë zëvendësuar me 4 lëndë të reja me një total prej 30 ECTS nga 256 ECTS për programin në tërësi. Ndryshimet në këtë program përbënë 11.7% të gjithë programit.

Ndryshimet janë rezultat i përmirësimit të vazhdueshëm që Departamenti bën në lidhje me përmirësimin e programit mesimor. Përmirësimet janë të bazuara në feedback-un e marrë nga studentët, zhvillimi i tregut të punës, stafi akademik dhe eksperiencia që mbart ai. Ndryshimet e propozuara i nënshtrohen jo vetëm një diskutimi në departament, por i nënshtrohen edhe ekspertizës së SUNY-ESC duke qenë se si plani mësimor edhe syllabuset e lëndëve duhet të jenë të sinkronizuara me këtë universitet. Ky është një tregues i qëndrueshmërisë në program dhe zhvillimit bashkëkohor të tij.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabelat 13)

Tabelat nga 13.1 në 13.6 në aneks pasqyrojnë planin mësimor të lidhur me personelin akademik përkatës për 6 vitet e fundit akademike.

Ky program studimi ofrohet nga një staf akademik me grada të duhura shkencore dhe me përvojë në fushën profesionale [aneks 2.1 – CV të personelit akademik]. Pjesëmarrja e stafit akademik në konferenca kombëtare, ndërkombëtare dhe botimet janë tregues të zhvillimit profesional të tyre e cila reflektohet edhe në përmbajtjen e syllabuseve.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Pedagogëve përkatës të lëndëve u është kërkuar të njekin një model të syllabuseve, i cili pasqyron elementët bazë si në listën e mëposhtme:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Orari dhe vendi i zhvillimit
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Syllabuset janë të konceptuar qartë dhe në përputhje me standartet e kërkuara. Përmbajtja e tyre është paraprakisht aprovuar nga State University of New York/ESC (për diplomë të dyfishtë). Ato janë të strukturuar duke ofruar një konceptim të qartë të objektivave dhe tematikës që zhvillohet. Në to jepen qartë temat që zhvillohen, detyrimet e lëndës, lidhja e tyre me lëndë me parakusht, mënyra e vlerësimit dhe data e provimit. Në syllabus jepen qartë orët e leksioneve të cilat në vetvete përmbajnë orët e simeinareve dhe orët laboratorike ndonëse tematika për këto nuk është dhënë e qartë. Rekomandojmë që këto komponentë të përfshihen në syllabus për të konsideruar më qartë çfarë studentit përfton në fushën e praktikës profesionale.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me Profil "Sistemet e Informacionit" është akredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Nr.384, datë 6.9.2013, për një periudhë 6 vjeçare. Ky program, me kohëzgjatje 4 vjet, përfundon me diplomën Bachelor dhe ofrohet i organizuar në module dhe i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe grumbullimit të Krediteve (ECTS).
Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	
	Për të katër vitet e studimit, studentit duhet të grumbullojë 256 kredite ECTS që të diplomohet. Për çdo viti akademik trajtohen

	lëndë të cilat janë me karakter të formimit të përgjithshëm 18.75%, të disiplinës karakterizuese 45.31%, lëndë ndërdisiplinore 16.4%, lëndë plotësuese 16.4% dhe diploma 3.2%.
--	--

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.

Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;

Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;

Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikatat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.

Studentët janë në dijeni të përmbajtjes së Programit të studimit edhe nga Student Handbook i cili përshkruan qartë synimet e programi të studimit dhe rezultatet e pritshme të tij. UNYT dhe Departamenti i Informatikës Ekonomike organizojnë edhe ditën e orientimit ku informohen studentët në lidhje me aspektet e programit të studimit si dhe informacione të tjera mbi jetën studentore. Stafit akademik i Departamentit të Informatikës Ekonomike pajis studentët me syllabuse në fillim të çdo semestri përkatësisht për lëndët që do të trajtohen.

Midis stafit akademik dhe studentëve ka një komunikim aktiv për shpërndarje të informacionit dhe literaturës detyruese dhe shtesë që mund t'ju nevojitet studentëve [**takim me studentët**].

Konkluzionet e vlerësimit:

- Programi i Studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me Profil Sistemet e Informacionit u hap në vitin 2002 dhe ofron një diplomë të dyfishtë.
- Programi i studimit ofron 256 ECTS të cilat janë të shpërndara sipas një plani mësimor të detajuar dhe të miratuar nga Senati Akademik dhe partnerët e huaj (për diplomë të dyfishtë).
- Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit ka objektiva të caktuara dhe rezultate të pritshme në fund të studimit të tij.
- Planu mësimor është në akordancë me standartet dhe VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 ndonëse rekomandojmë një përmirësim të tij në lidhje me vendosjen e praktikave profesionale e cila u konsiderua e nevojshme edhe nga ana e studentëve.
- Leksionet, seminarët dhe orët laboratorike janë të inkorporuar në një të vetme dhe kjo është e shprehur qartë edhe në syllabuset. Rekomandojmë që në këto të fundit të shprehen qartë edhe tematika e seminarëve dhe orët laboratorike për të krijuar një konceptim më të qartë të trajtimit të teorisë në aspektin praktik dhe laboratorik.
- Programi i studimit mbulohet nga një staf me eksperiencë dhe me kohë të plotë.
- Evidentojmë literaturë detyruese dhe ndihmëse të mjaftueshme dhe disponibël për studentët në bibliotekë.

8. Mësimdhënia

Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit ofrohet për një periudhë 4-vjeçare me një total 256 ECTS me një ngarkesë totale në auditor 1875 orë. Ky program realizohet në një kombinim orë leksioni, seminarë, orë laboratorike dhe punë të pavarur të studentit. Ky

program studimi ofrohet në 6 veprimtari formuese të cilat janë në përputhje me standartet dhe kërkesat e Ministrisë së Arsimit Sporteve dhe Rinisë dhe në akordancë me standartet që ofrohen nga partnerët e huaj me të cilët ky universitet bashkëpunon.

Ky program studimi mbulon 6 veprimtari formuese si më poshtë (Tabela 11):

- Kategoria A: Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm e cila mbulon 8 lëndë ka një peshë 18.75%;
- Kategoria B: Veprimtari në disiplina karakterizuese të programit të studimit e cila mbulon 17 lëndë dhe ka një peshë 45.31%;
- Kategoria C: Veprimtari në disiplina të ngjajshme dhe/ose integruese, që lidhen me disiplinat karakterizuese e cila mbulon 7 lëndë dhe ka një peshë 16.4%%;
- Kategoria D: Disiplina me zgjedhje të studentit, ndër disiplinat e ofruara nga institucioni e cila mbulon 2 lëndë dhe ka një peshë 6.25 %;
- Kategoria E: Njohuri të tjera formuese, si plotësime në gjuhë të huaja, informatikë, prezantuese, stazh apo praktikë, etj e cila mbulon 4 lëndë dhe ka një peshë 10.15%;
- Kategoria F: Teza e diplomës – 3.2%;

Përmbajtja e secilës lëndë është e shprehur qartë në syllabus [**aneks 2.2 – syllabuset e lendeve**]. Në secilin syllabus të shqyrtuar është përcaktuar qartë emërtimi i lëndës, njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës, temat që trajton në formimin teorik dhe atë praktik, ngarkesa në auditor dhe jashtë saj e shprehur në ECTS. Gjithashtu në syllabus janë shprehur edhe format dhe metodika e mësimdhënies për secilën lëndë dhe raportet e tyre.

Në fillim të çdo viti akademik studentëve u bëhet e qartë rregullorja e lëndës, përmbajtja e syllabusit dhe detyrimet përkatëse që ka në lidhje me vlerësimin e njohurive. Këto janë të shprehur qartë në syllabus dhe u vërtetuan edhe në takimin e bërë me studentët. Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me Profil Sistemet e Informacionit ofron një literaturë të gjera detyruese dhe ndihmëse. Duke konsideruar që programi i studimit është në shkencat kompjuterike, ofrimi i tij në gjuhën angleze e bën më të thjeshtë plotësimin me literaturë ndihmëse dhe detyruese bashkëkohore pa qenë e nevojshme përkthimi i saj në gjuhën shqipe. Kjo ka sjellë edhe në një asimilim më të shpejtë të studeteve me konceptet dhe terminologjinë bazë dhe njëkohësisht ka krijuar mundësinë që ata të ballafaqohen me një literaturë e kohëve të fundit.

Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me Profil Sistemet e Informacionit ofron edhe diplomë të dyfishtë. Në lidhje me këtë organizohen orë leksioni online me staf akademik nga SUNY – ESC University. UNYT ofron një infrastrukturë të duhur për të organizuar në mënyrë efektive këto orë leksioni. Kryesisht këto zhvillohen në laboratore ku edhe studenti ka mundësi të konkretizojë qartë njohuritë që jepen [**vizitë në laboratore dhe takim me përfaqesues të IT**].

Kontrolli i njohurive bëhet përmes pjesëmarrjes në orë leksioni, seminare, orë laboratorike, detyra kursi dhe përmes provimit të ndërmjetëm që zhvillohen në mes të një semestri akademik dhe provimin final i cili mbulon të gjitha temat që nuk janë prekur në provimin e ndërmjetëm. Nga shyrtimi i syllabuseve dhe takimet me stafin akademik dhe studentët evidentojmë forma të ndryshme të vlerësimit. Në një pjesë të lëndëve të cilat kanë detyra kursi dhe orë laboratorike janë paraqitur qartë detyrimet dhe penaltetet nëse studenti nuk e dorëzon në kohën e duhur (duke ulur 10% të vlerësimit përfundimtar). Këto shprehin një diversitet të formave të vlerësimit dhe janë në përputhje me përmbajtjen e lëndës dhe konceptimit të saj në mësimdhënie.

Syllabuset janë subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Ndonëse në programin e studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit janë bërë ndryshime në total 4 lëndë, për periudhën 2013 – 2018 ai ka qenë subjekt i rishikimit të vazhdueshëm. Në këtë rishikim marrin pjesë aktive staf akademik, studentë përmes dhënies së feedback (NJSBC luan një rol aktiv), studentët e diplomuar dhe

partnerët e huaj të cilët për diplomë të dyfishtë rishikojnë me vëmendje përmbajtjen dhe format e trajtimit të saj.

Shkëmbimi i informacionit me studentët lidhur me lëndët përkatëse realizohet nëpërmjet faqeve web të dedikuara. Çdo lëndë ka një website ku pedagogu jo vetëm transmeton materialet e nevojshme për përvehtësimin e lëndës, por pasqyron edhe rezultatet e provimeve apo edhe të vlerësimeve të tjera të kryera.

Çështje të kontrollit të njohurive, si provimet, riprovimet, përmirësimi i notës, kriteret e mbartjes dhe ecurisë akademike, etj. trajtohen në Rregulloren e programit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

Programi i studimit Bachelor ne Shkenca Kompjuterike me Profil Sistemet e Informacionit synon një aftësim teorik dhe praktik të studentëve përmes ofrimit të metodave dhe teknikave më të mira të mësimdhënies. Përmirësimi i infrastrukturës dhe përzgjedhja e stafit akademik me eksperiencë në mësimdhënie dhe ofrimi i trajnimit të tyre janë tre nga qëllimet bazë të shprehur edhe në Strategjinë e Zhvillimit 2018 – 2022 të cilat mundësojnë që në këtë program studenti të ketë mundësi të zhvillojë aftësinë e analizimit dhe zgjidhjes të problematikave komplekse dhe të zhvillojë punën në grup.

Teknikat e mësimdhënies janë të shprehur edhe në Rregulloren e Programit të Studimit përmes rezultateve të pritshme dhe në secilin syllabus.

Në këtë program studimi nuk kemi një ndarje të përcaktuar qartë numrin e orëve të leksioneve. Në brendësi të tyre janë të inkuorporuar orët e seminareve dhe orët laboratorike. Kjo është e shprehur edhe në syllabus dhe u mbështet edhe në takimet me stafin akademik. Ndonëse evidentojmë një formë e cila ecën në vijueshmëri me vështirësinë e temës që trajtohet në kuadrin teorik dhe në përputhje me progresin e studentëve, **rekomadojmë që në syllabus të shprehet tematika e orëve të seminareve dhe laboratorit në mënyrë që të krijohet një kuadër i qartë të formimit teorik dhe praktik të studentëve.**

Në tabelën 14 në aneks pasqyrohen vetëm orët totale në auditor.

Format e kontrollit të njohurive (Tabela 15)

Kontrolli i njohurive përgjithësisht organizohet në trajtën e dy provimeve, ai ndërmjetës dhe ai final dhe sipas lëndëve integrohen edhe elementë të tjerë si detyrat, projektet etj. Kontrolli i njohurive është i vazhdueshëm dhe ndjek progresin e studentëve. Sic theksuam edhe me përpara në secilin syllabus janë të shprehur qartë edhe penalizimet në rast të vonës në dorëzim të detyrave të kursit. Studenti në çdo lëndë ndërgjegjësohet edhe për penelizimet në plegjaturë dhe në kopje, ndonëse kjo e gjejmë këtë si një politikë gjithëpërfshirëse që trajtohet në këtë institucion. Shkalla e vlerësimit që aplikohet në programet 4 – vjeçare Bachelor në UNYT është sipas modelit amerikan. Notat specifikohen me anet e shkronjave A-F, të cilat korrespondojnë me notat në përqindje (Tabela 15 a).

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj (Tabela 16)

Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit synon në një aktivizim të studentëve në të gjithë komponentët e tij. Studentët e diplomuar kanë mundësi punësimi në këtë institucion i cili i inkurajon ata të thellojnë njohuritë e tyre në programe Master i Shkencave dhe më të mirët të punësohen si staf akademik në këtë institucion. Ndonëse numri i studentëve në këtë program është i ulët evidentojmë përpjekje në lidhje me aktivizim të studentëve në projekte në rang Departamenti (9 studentë).

9. Studentët

UNYT i kushton një vëmendje të veçantë përthithjes së studentëve më të mirë në këtë universitet. Për këtë nga Zyra e Karrieres & Alumni organizohen edhe takime të përvitshme me shkollat e mesme dhe zbatohet një politikë marketingu dhe sensibilizimi në lidhje me mundësitë dhe cilësinë e programit të studimit. Kjo është e shprehur edhe në qëllimin nr. 2 në Strategjinë e Zhvillimit 2018-2022 të institucionit ku një theks i veçantë i kushtohet tërheqjes së studentëve më të mirë në këtë program. Nga takimi me studentët evidentuam një shtrirje gjeografike të tyre nga Shkodra, Lushnja etj. të cilët kishin marrë informacion nga takimet e zhvilluara dhe nga fushatat mediatike të bëra nga përfaqësues të UNYT. Institucioni përmes Zyrës së Karrierës & Alumni ndjek një politikë sensibilizimi dhe promovimi në lidhje me rritjen e numrit të studentëve të regjistruar në këtë institucion.

UNYT ndjek një politikë të qartë në lidhje me zbatimin e kriterëve të pranimit të studentëve në këtë program studimi. Këto kriterë janë në përputhje me standartet dhe kërkesat që legjislacioni shqiptar në fuqi ofron dhe në vijueshmëri me Rregulloren e Studimit. Mundësia e ofrimit të një diplomë të dyfishtë bën që ky institucion në të njëjtën kohë të ndjekë edhe kriterë pranimi dhe transferimi të studentëve në universitetin SUNY – ESC University.

Procedurat aktuale të pranimit të studentëve të rinj në programin 4-vjeçar Bachelor në Shkenca Kompjuterike me Profil Sistemet e Informacionit janë të përshkruara qartë në Rregulloren e Zyrës së Pranimit të Studentëve [vizite në këtë zyrë, aneksi 18.1: **admission Office Rules & Regulations**]. Në mënyrë koncize nga sa na u theksua edhe nga Përgjegjësja e kësaj zyre mund të konkludojmë se në bazë të vendimit të Rektoratit zbatohen kriteret shtesë të pranimit:

1. Notë mesatare të shkollës së mesme mbi 6.5;
2. Niveli i gjuhës angleze B1.

Duke verifikuar në mënyrë rastësore dosje të studentë të regjistruar për herë të parë dhe studentë të transferuar për këtë program studimi, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni si edhe mbështetur mbi atë çfare u theksua nga drejtuesja e kësaj zyre gjejmë një përputhshmëri në lidhje me zbatimin e procedurës së pranimit të studentëve. Në dosjet e evidentuara gjetëm dokumentacionin e mëposhtëm për regjistrim:

1. Formulari i Aplikimit;
2. Fotokopjen e noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore ose të dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njësuar në MASR;
3. 4 (katër) fotografi me përmasat e pasaportës;
4. Deklaratën e paraqitur në shtojcën, bashkëlidhur udhëzmit përkatës të atij viti akademik (i nënshkruar nga aplikanti dhe nga punonjësja e sekretarisë).

Numri total i studentëve të regjistruar në 6 vitet e fundit është 44, nga të cilët 26 studentë të transferuar.

Pas regjistrimit dhe transmetimit të informacionit dhe dokumentacionit nga Zyra e Pranimeve, Sekretaria mësimore mban gjithë informacionin në lidhje me progresin e studentit gjatë viteve të studimeve e deri në diplomimin e tij.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

UNYT ka në strukturën e vet Zyrën e Pranimeve (“Admissions Office”), e cila sigurohet për ndjekjen e procedurave të duhura për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të rinj. Procedurat aktuale të pranimit të

studentëve të rinj në programet bachelor janë të përshkruara në rregulloren e Zyrës së Pranimeve, pika 4 [Aneksi 18.1: Admissions Office Rules & Regulations]. Ato përmbledhen me hapat e mëposhtëm:

- Para-aplikimet për regjistrim në programet e ciklit të parë të studimeve në UNYT janë të mundura në çdo kohë të vitit akademik.
- Aplikantët mund të aplikojnë nëpërmjet ueb-it, e-mail-it, telefonit ose duke vizituar ambientet e UNYT ose/edhe sipas përcaktimeve në ligjet përkatëse.
- Zyra e pranimeve (ZP) kontrollon kualifikueshmërinë e aplikantit bazuar në kriteret e pranimit të përcaktuara me vendimin përkatës të Rektoratit.
- Zyra e pranimeve (ZP) njofton aplikantin duke përdorur informacionin e tij / saj të kontaktit për para-pranimin; dhe nëse aplikanti është pranuar për regjistrim i bëhet e ditur lista e dokumenteve të nevojshme të regjistrimit.
- Nëse kandidati nuk posedon një rezultat të suksesshëm në asnjë prej Certifikatave të njohura të Gjuhës Angleze atëherë kandidati i nënshtrohet testit Aptis, që organizohet nga Zyra e pranimeve (ZP) në bashkëpunim me British Council.
- Zyra e pranimeve (ZP) kontrollon listën e dokumenteve të dorëzuara nga kandidati për vlefshmërinë.
- Zyra e pranimeve (ZP) dërgon dosjen e kompletuar në Komisionin e Pranimit për miratim dhe pastaj dosjet transferohen në Zyrën e Regjistrimit

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Cilësia në hyrje.

Për studentët e regjistruar në 6 vitet e fundit rezultojnë një notë mesatare në hyrje sipas viteve që varion nga 8.9 në 9.2. Kemi një rënie të mesatares së studentëve për periudhën akademike 2014 – 2016 ndërsa për vitin akademik 2018 – 2019 evidentojmë një rritje të saj në 9.2. Kjo dëshmon edhe fokusin e këtij institucionin në përthithjen e studentëve më të mirë dhe cilësor të cilët në Strategjinë e UNYT do të shërbejnë në të ardhmen si kontigjent për studimet në Master i Shkencave dhe Doktoratë dhe punësim të tyre si staf akademik në këto programe studimi [strategjia e zhvillimit 2018 – 2022].

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Nuk ka patur studentë të cilët kanë realizuar mobilitete brenda sistemit të arsimit të lartë në vend.

Të dhëna për punësimin e studentëve: UNYT mban një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e studentëve të diplomuar në fushën përkatëse të tyre. Në programin e studimit Bachelor në Shkenca Komjuterike me profil Sistemet e Informacionit numri i studentëve të diplomuar është i ulët por evidentojmë që në një masë mbi 80 % e tyre janë të punësuar sipas fushës së diplomimit të tyre, çka thekson kërkesën në treg për këtë profil studimi dhe aftësimin e mirë të studentëve në këtë program studimi.

Numri total të diplomuarve: Për 6 vitet e fundit janë diplomuar 11 studentë.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën): Të dhënat në lidhje me punësimin e studentëve mbahen nga zyra e Karrieres & Alumni. Në total për periudhën akademike 2013 – 2018 janë diplomuar 11 studentë ku 10 prej tyre janë punësuar sipas fushës së studimit të tyre. Kjo dëshmon për cilësinë e përgatitjes së të diplomuarve në këtë program studimi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>UNYT ndjek një politikë të qartë për pranimin e studentëve në programin e studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me profil Sistemet e Informacionit.</p> <p>Procedura e pranimit të studentëve është e shprehur në Rregulloren e Pranimeve dhe ndiqet nga Zyra e Pranimeve. Për periudhën akademike 2013-2018 nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion gjejmë një përputhje të zbatimit të kësaj procedure. Kriteret e pranimit të studentëve janë sipas akteve ligjore në fuqi. Këto kritere janë në përputhje edhe me kriteret e pranimit të SUNY – ESC University (SHBA).</p> <p>Për këtë program studimi janë vendosur edhe kritere shtesë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • notë mesatare të shkollës së mesme mbi 6.5; • Niveli i gjuhës angleze B1 <p>ndonëse nga të dhënat e marra evidentojmë që nota mesatare e pranimit për këtë program studimi është e lartë dhe për vitin akademik 2018 – 2019 është 9.2.</p>
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>UNYT i kushton një vëmendje të veçantë përthithjes së studentëve më të mirë në programin e studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me Profil Sistemet e Informacionit. Në tërësinë e tij ky institucion harton edhe një politikë marketingu që ndiqet nga Zyra e Karrierës & Alumni dhe Departamentet. Staf i akademik është aktiv në takimet informuese të studentëve në procedurën e para – pranimit e cila kryhet në çdo kohë gjatë vitit akademik. UNYT përdor të gjithë mjetet dhe teknikat informuese në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit. Vlen të theksohen informimi përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - faqes së internetit - http://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/computer-science/ - Manualit të Studentit (STUDENT HANDBOOK); - Ditës së orientimit; - Koordinatorit të programit. - Rrjete sociale si facebook, instagram, twitter etj. <p>Studentët marrin pjesë aktive në vlerësimin e përfundimit të stafit. Për këtë ata janë pjesë e anketimeve që zhvillohen dy herë në vit. Në mënyrë anonime ata kanë mundësi të vlerësojnë pedagogun e lëndës në shumë komponentë si: mësimdhënie, komunikim, trajtim të kuadrit teorik, përgatitjes profesionale etj. Numri i studentëve që marrin pjesë në këto anketime është rritur në vitet e fundit dhe është një tregues i ndërgjegjësimit të tyre në lidhje</p>

	<p>me rëndësinë e këtyre procedurave.</p> <p>UNYT ka në strukturën e vet Zyrën e Karrierës dhe të marrëdhënieve me të diplomuarit, e cila ofron një sërë shërbimesh në ndihmë të punësimit të studentëve dhe mbajtjen e kontakteve me ta pas punësimit. Zyra e Karrierës & Alumni luan rol në informimin e studentëve për mundësitë në punësim. Për këtë ajo shfrytëzon shumë kontaktet me kompani biznesi. Në punësim të studentëve një rol luajnë edhe stafi akademik. Shembuj u sollën nga përgjegjësi i zyrës së Karrierës & Alumni ku për këtë program studimi shumë oferta kanë ardhur përmes stafit akademik të cilët shfrytëzojnë kontaktet e tyre me kompani biznesi për të mundësuar punësimin e studentëve. Punësimi i studentëve nga kjo zyrë bëhet përmes dy mënyrave:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Hartimi i një shortlist; 2. Mbledhja e CV të studentëve dhe selektimi i tyre në përputhje me kërkesat për punësim që vijnë nga kompanitë dhe institucionet.
--	---

Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.

Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;

Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;

Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.

UNYT ka një sistem informativ E-GNOMON për ruajtjen dhe mbajtjen e të dhënave të studentëve, stafit akademik dhe progresit të tyre. Të dhënat e studentëve si regjistrimi i tyre, rezultatet e provimeve etj hidhen në këtë sistem dhe janë të aksesueshme nga studentët.

UNYT ka të ngritur Sekretarinë Mësimore detyrat e të cilës janë të shprehur qartë në Rregulloren e kësaj zyre dhe në Statut. Sekretaria Mësimore është përgjegjëse për regjistrimin e studentëve, hedhjen e notave të cilat monitorohen nga një komision i departamentit dhe nga NJSBC. Sekretaria mësimore bashkëpunon me Student Advisor në lidhje me modulet që studenti duhet të regjistrojë në fillim të çdo vitit akademik.

Nga dokumentacioni i shlytur dhe vizita në këtë zyrë evidentojmë një përputhje të zbatimit të procedurës së regjistrimit të studentëve dhe ruajtjes dhe depozitimit të të dhënave në formë elektronike dhe në arshive. Sekretaria Mësimore është përgjegjëse edhe për mbajtjen e informacionit për studentët e transferuar dhe ata të larguar.

Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;

Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

UNYT në formën e tij të organizimit i jep një mbështetje studentit në të gjithë periudhën e tij të studimit. Format e mbështetjes janë:

1. Student Advisor (Këshillues i studentit) i cili ofron këshillim studentëve për numrin e lëndëve që duhet të marrin në fillim të çdo semestri.
2. Stafit akademik që jep ndihmë në orë të veçanta për çdo student që ka vështirësi në lëndë;
3. Specialistët e laboratorëve të cilat qëndrojnë në orë të veçanta për studentët të cilët shprehin interes të punojnë në këto

	<p>laboratorë;</p> <p>4. Stafi i bibliotekës që punon gjatë javës dhe ditën e Shtunë dhe të Djelë duke mundësuar studentët të shfrytëzojnë literaturën dhe të studiojnë në këto ambiente.</p> <p>Zyra e Karrierës & Alumni luan një rol të rëndësishëm me mbështetjen që i jep studentëve për fazën e aplikimit në kompani biznesi. Për këtë kjo zyrë organizon panairin e karrierës ku kompani biznesi kanë mundësi të njihen me studentë nga programi i studimit. Zyra e Karrierës & Alumni ndihmon studentët për të hartuar CV dhe si të përballojnë intervista pune. Kjo zyrë bashkëpunon me stafin akademik për punësim të studentëve në fund të studimeve të tyre.</p>
--	--

Konkluzionet e vlerësimit:

1. UNUT ndjek politika të qarta pranimit të studentëve. Këto kriere janë në përputhje me kriteret e partnerëve të huaj dhe akteve ligjore dhe nënligjore në Republikën e Shqipërisë.
2. UNYT zbaton me rigorizotet Rregulloren e Pranimit dhe Zyra e Pranimit është përgjegjëse për implementimin e politikave në lidhje me pranimin e studentëve në këtë program studimi.
3. UNYT harton politika marketingu në lidhje me përthithjen e studentëve më të mirë e cila është në fokus edhe të Strategjisë së Zhvillimit të UNYT për periudhen 2018-2022
4. UNYT ka vendosur edhe kritere suplementare pranimit për këtë program studimi si notë mesatare të shkollës së mesme mbi 6.5 dhe nivel të B1 të gjuhës angleze por të dhënat tregojnë për një mesatare mbi 9 pranimit të studentëve në këtë program studimi.
5. UNUT zbaton mënyra të ndryshme të informimit të studentëve. Këto i gjejmë të shprehura në Rregulloren e programit të studimit dhe në Rregulloren e Pranimit të Studentëve.
6. UNYT ka një sistem informacioni që menaxhohet nga Sekretaria Mësimore ku ruhen rekorde të plota të gjithë progresit të studentit gjatë fazës së studimeve dhe të diplomimit;
7. Pranë UNYT funksionon Zyra e Karrierës dhe të marrëdhënieve me të diplomuarit e cila i ndihmon studentët për aspekte të ndryshme të zhvillimit të karrierës.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

UNYT i kushton një vëmendje të veçantë kërkimit shkencor. Këtë e gjejmë të shprehur në Strategjinë e Zhvillimit 2018 – 2022 (qëllimi nr.1) si edhe në Dokumentin mbi Drejtimet Kryesore të Kërkimit Shkencor 2018-2022. Fushat prioritare të kërkimit përcaktohen në bazë të profilin të institucionit, interesave dhe objektivave të kërkimit shkencor të Fakulteteve (këtu futet edhe Fakulteti i Informatikës) si edhe prioriteteve të Fushës së Kërkimit Evropian. Në Dokumentin “Shtylla e Kërkimit 2013 – 2018) jepen qartë edhe synimet e UNYT në lidhje me drejtimet e kërkimit shkencor. Këto prioritete janë riformuluar për periudhën 2018-2022 [aneksi 21.3 Reserach Pillar 2018-2022] duke qartësuar edhe objektivat e institucionit në lidhje me zhvillimin e kërkimit shkencor për programet e studimit. Në funksion të mbështetjes së kërkimit shkencor janë ngritur edhe 3 qendra të saj ku njëra bën pjesë edhe në Fakultetin e Informatikës. Objektivat bazë institucionale të shprehura në 5 shtyllat e kërkimit shkencor në nivel

institucional i gjejmë të zberthyera për secilin fakultet. Konkretisht për Fakultetin e Informatikës evidentojmë drejtimet:

1. Sistemet Inteligjente dhe Aplikacionet;
2. Inxhinieria softuerike dhe Sistemet e Informacionit;
3. Teoria e Komputacionit.

UNYT kryen një punë për të lidhur kërkimin shkencor me mësimdhënien. Lëndë si Arkitektura e Kompjuterave, Sistemet Operative, Rrjete Kompjuterike, Analiza dhe Projektimi i Sistemeve, Struktura e të Dhënave, Sistemet DataBazave, Siguria e Kompjuterave, Zhvillimi i Sistemeve Web, Sistemet e Informacionit dhe Menaxhimit janë përditësuar me zhvillimet reja të arritura nga kërkimi shkencor (projekte dhe pjesëmarrje të stafit akademik në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare ose publike në revista shkencore).

Kërkimi Shkencor në funksion të Programit të Studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me Profil Sistemet e Informacionit bën pjesë në shtyllën nr. 2 (Inxhinieria Softuerike dhe Sistemet e Informacionit) dhe në shtyllën nr. 3 të kërkimit institucional (Shkenca, Teknologjia dhe Shoqëria). Në shtyllat kërkimore për vitin 2018-2022, kjo fushë është promovuar si shtyllë kërkimore më vete. Kërkimi shkencor në Fakultetin e Informatikës, dhe veçanërisht për këtë program studimi ka në fokus edhe rritjen e pjesëmarrjes së studentëve. Aktualisht për këto fusha kërkimi studentët inkurojohen të trajtojnë tema të diplomës të cilat janë në përputhje me fushën prioritare të këtij program studimi në drejtim të kërkimit shkencor.

Evidentojmë një pjesëmarrje të stafit akademik në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare dhe publikime në revista shkencore. UNYT monitoron progresin e stafit akademik për kërkimin shkencor. Në fillim të vitit akademik stafi plotëson formularë në lidhje me objektivat individuale për kërkim shkencor të cilat në fund të vitit akademik analizohen dhe reflektohen në raportin vjetor të Departamentit. Zbatimi i një politike promovimi dhe sistemi të matjes së cilësisë të produktit kërkimor janë evidencime të cilat shprehin fokusin që UNYT i kushton këtij drejtimi me impakt në cilësinë e programeve të studimit. Në fakultetin e Informatikës në mbështetje të punës kërkimore të stafit akademik është ngritur edhe Qendra për Kërkime të Avancuara Kompjuterike e cila është themeluar në vitin 2017-2018 si reflektim i nevojës për kërkim shkencor. Nga vizita në institucion dhe takimet e kryera evidentojmë që kjo Qëndër është akoma e dobët për të luajtur një rol mbështetës në drejtim të kërkimit shkencor.

Rekomadojmë një fuqizim të punës së saj me impakt në cilësinë e programit të studimit dhe të Fakultetit të Informatikës në tërësi. Ndonëse në rang institucional janë ngritur tre qendra kërkimore nuk gjejmë evidenca të qarta në lidhje me mënyrën e koordinimit dhe bashkëveprimin të tyre në funksion të rritjes së kërkimit shkencor.

Në lidhje me programin e Studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me Profil Sistemet e Informacionit gjejmë një pjesëmarrje të gjerë të stafit në projekte kërkimore shkencore. Outputi shkencor individual vlerësohet sipas kategorizimit dhe është e rregulluar me dokumentin "Weight of Research Output" në të cilin kategorizohen rezultatet shkencore dhe intelektuale dhe ku secilit i jepet pesha e merituar [aneksi 25.1: Sistemi për Vlerësimin e Kërkimit Shkencor – Fakulteti i Informatikës].

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor**

Kërkimi shkencor është në fokus të punës së Fakultetit të Informatikës dhe veçanërisht të Departamentit të Informatikës Ekonomike ku ofrohet edhe programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me Profil Sistemet e Informacionit. Aktivitetin shkencor mund ta përmbledhim në drejtimet:

1. Botime shkencore nga stafi akademik: 61 libra, 117 artikuj në revista të rishikuara nga ekspertët, 209 pjesëmarrje në konferenca me proceedings;
2. Projekte kërkimore të fituara në rang institucioni: 16 institucionale dhe 7 ndër-institucionale; Në këtë drejtim janë zbatuar 4 projekte.
3. Pjesëmarrje në aktivitete shkencore të organizuara nga UNYT: 5 Konferenca (çdo fakultet organizon një konferencë të saj), 18 konferenca në nivel Master i Shkencave dhe Doktorature;
4. Impakti i kërkimit shkencor në procesin mësimor: 9 module të përmiresuara si rezultat i arritjeve shkencore të pedagoqeve të lëndës;
5. Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor: 9 studentë të përfshirë ndonëse nuk janë të dhëna të qarta në lidhje me numrin studentëve për këtë program studimi;

Në konkluzion GVJ është i mendimit se:

- UNYT i kushton një vëmendje të veçantë kërkimit shkencor. Kjo shprehet në dokumenta bazë që kanë të bëjnë me drejtimet e kërkimit shkencor;
- UNYT ka të ngritur Qendrat Kërkimore Shkencore dhe për Fakultetin e Informatikës është ngritur edhe Qendra për Kërkime të Avancuara Kompjuterike. Rekomandojmë një rritje dhe fuqizim të qëndrës në funksion të mbështetjes së kërkimit shkencor në nivel fakulteti.
- Kërkimi Shkencor për programin e studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me Profil Sistemet e Informacionit gjendet i inkorporuar në Departamentin e Informatikës Ekonomike. Ky departament ka objektiva të qarta kërkimi që reflektohen në shtyllën 2 dhe 3 të kërkimit shkencor në nivel institucional.
- UNYT ka të ngritur një sistem monitorimi dhe vlerësimi të punës kërkimore shkencore të stafit akademik e cila shprehet edhe në dokumentin “Weight of Research Output”.
- Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi ndjek një plan të përcaktuar qartë kërkimi shkencor individual i cili është subjekt analizimi në fund të vitit dhe pasqyrohet në raportin vjetor të Departamentit të Informatikës Ekonomike.
- Evidentojmë një pjesëmarrje të gjerë të stafit akademik në projekte, konferenca me proceeding dhe botime në revista shkencore;
- Nuk kemi të dhëna në lidhje me numrin e studentëve nga ky program të angazhuar në projekte shkencore. Reflektimi i shtyllave nr. 2 dhe 3 të kërkimit shkencor për këtë program studimi reflektohen në temat e diplomës.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

UNYT i kushton një vëmendje të veçantë politikës së ndërkombëtarizimit të bashkëpunimit dhe rritjes së partneritetit në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Për këtë rritje e numrit të studentëve të huaj është në fokus të qëllimit nr.1 në Strategjinë e Zhvillimit 2018- 2022. Rritja e partneritetit me universitete të tjera përmes projekteve kërkimore shkencore është evidente në këtë institucion. Ndërkombëtarizimi i anetarëve të fakultetit është e shprehur edhe në objektivar e Strategjisë (2018-2022) ndërsa politika e ndërkombëtarizimit është e theksuar qartë në Strategjinë e Ndërkombëtarizimit (2018-2022). Çështjet e bashkëpunimit kombëtar, ndërkombëtar dhe mobilitetit në UNYT menaxhohen nga Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Zyra e Koordinimit me ESC (për diplomë të dyfishtë) ndërsa lidhjet me komunitetin e biznesit janë në fokus të Zyrës së Karrierës & Alumni.

GVJ gjatë vizitës në Zyrën e Koordinimit me ESC u njoh me aktivitetin e kësaj zyre që drejtohej nga Koordinatorja e ESC. Aktiviteti kryesor konsistonte në menaxhimin e diplomës së dyfishtë me ESC duke mundësuar rregjistrimin e studentëve për këtë diplomë (pas përfundimit të 60 krediteve amerikane dhe rezultateve të larta) si dhe ndjekjen e tyre deri në diplomim. Gjithashtu kjo zyrë mundëson koordinimin edhe me zyra homologe të tjera si në Pragë, Athinë e Selanik.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

UNYT bashkëpunon ngushtë me SUNY – ESC University duke ofruar një diplomë të dyfishtë. Në nivel Master i Shkencave bashkëpunon përmes marrëveshjes së bashkëpunimit me University of Greenwich. Gjithashtu në tabelën 21 dhe 22 evidentojmë një sërë marrëveshje bashkëpunimi me partnerë të huaj, institucione shtetërore dhe komunitet të biznesit. Këto janë shprehje e një bashkëpunimi aktiv me impakt në programin e studimit në drejtim të përmbushjes së objektivave të tij.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me Profil Sistemet e Informacionit realizohet përmes një angazhimi të stafit akademik të Departamentit të Informatikës Ekonomike me Departamentin e Shkencave Kompjuterike dhe stafit akademik të Fakulteteve të tjera. Dëshmi të një koordinimi të mirë të punës së tyre u dha në takimet e zhvilluara në institucion. Evidentojmë shkëmbime eksperience dhe informacioni midis tyre. Research Output 2012 – 2018 tregon për pjesëmarrje të stafit akademik në projekte kërkimore shkencore dhe botime të përbashkëta në revista shkencore.</p> <p>Një kontribut të veçantë në këtë shkëmbim luan edhe vlerësimi i punës së stafit akademik jo vetëm nga studentët, por edhe nga kolegët.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike me Profil “Sistemet e Informacionit” zhvillohet në bashkëpunim me Universitetin Shtetëror të New York-ut, Empire State College. Ky bashkëpunim bën të mundur që të përftohet një formim bashkëkohor dhe një vizibilitet ndërkombëtar i diplomës.</p> <p>Plus sa më sipër, UNYT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione të tjera jashtë vendit në mënyrë që të rrisë ndërkombëtarizimin e programeve të studimit dhe mundësuar shkëmbime të studentëve dhe personelit akademik [Memorandumet e bashkëpunimit me universitete e institute].</p> <p>UNYT zhvillon një bashkëpunim të gjerë me një numër të madh institucionesh publike, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, etj. Kjo kontribuon jo vetëm në realizimin e suksesshëm</p>

të praktikave të ndryshme, por edhe për kontakte me tregun e punës me qëllim punësimin e studentëve të diplomuar.

Konkluzionet e vlerësimit:

- UNYT ndjek një politikë në lidhje me rritjen e forcimit të ndërkombëtarizimit. Objektivat e kesaj politike i gjejmë në Strategjinë e Zhvillimit (2018-2022) dhe në Strategjinë e Ndërkombëtarizimit (2016-2022);
- Ka përpjekje të bashkëpunimeve me partnerë të huaj përmes projekteve të përbashkët shkencorë.
- Staf i akademik është aktiv në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare shkencore.
- UNYT dhe Fakulteti i Informatikës kanë marrëveshje bashkëpunimi me institucione shtetërore dhe komunitetin e biznesit.
- Ofrimi i diplomës së dyfishtë për nivelin Bachelor me Universitetin Shtetëror New York (The State Empire College) dhe arritja e marrëveshjes për Master i Shkencave me universitetin Greewich janë tregues të faktorit ndërkombëtarizim për këtë program studimi.

ANALIZË PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE

NGA AKREDITIMI PARAARDHËS

Rekomandimi a)	është plotësuar
Rekomandimi b)	është plotësuar
Rekomandimi c)	është plotësuar

ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS - PIKAT E FORTA, WEAKNESSES - PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES - MUNDËSITË, THREATS - PENGESAT).

a. Pika të forta:

- 1) Kërkesë e lartë e tregut të punës për studentë të diplomuar në këtë profil studimi;
- 2) Punësim i garantuar i studentëve në fund të studimeve të tyre;
- 3) Ofrimi i një diplome të dyfishtë përmes bashkëpunimit me Universitetin Shtetëror të New York-ut, Empire State College , SHBA.
- 4) Programi i studimit ofrohet në gjuhën angleze duke aftësuar studentët të punësohen edhe në kompani të huaja apo jashtë vendit.
- 5) Institucioni ofron një qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programit të studimit;
- 6) Institucioni ofron një infrastrukturë (salla leksioni, seminare dhe laboratorë) të duhur dhe modernë duke garantuar cilësinë në mesimdhënië.
- 7) Ofrimi i programit të studimit në gjuhën angleze sjell edhe përdorimin e një gamë të gjerë literature bashkëkohorë pa qenë e nevojshme përkthimi i tyre në gjuhën shqipe;
- 8) Cilësia e lartë e kurrikulës së ofruar për programin e studimeve bazuar në modelin amerikan

- 9) Institucioni ka ngritur strukturë monitorimi dhe matje të cilësisë së programit të studimit ne vecanti dhe universitetit në tërësi;
- 10) Institucioni angazhon staf akademik të huaj dhe vendas me grada dhe eksperience te duhur profesionale;
- 11) Bibliotekë që disponon një literaturë të gjerë bazë dhe ndihmëse në shërbim të programit të studimit e me akses të gjerë në biblioteka të ndryshme elektronike;

b. Pika të dobëta:

- 1) Ndryshimet e herë pas hershme në kohëzgjatjen e studimeve të programit BSc në Shkenca Kompjuterike me profil “Sisteme Informacioni” (diktuar nga nevoja për t’ju përshtatur ndryshimeve në aktet ligjore dhe nënligjore të arsimit të lartë në vend);
- 2) Mungesa e një studimi tregu të përditësuar në përputhje me Strategjinë e studimit të tregut të UNYT;
- 3) Mungesë koordinimi dhe bashkëpunimi të Qendrës për Kërkime të Avancuar Kompjuterike me Fakultetin dhe Qëndrat e tjera shkencore në Universitet.
- 4) Mungesë e praktikave profesionale në këtë program studimi

c. Mundësitë:

- 1) Ofrimi i një diplome të dyfishtë krijon mundësinë që Institucioni të ndjekë kritere pranimi dhe transferimi të studentëve në SUNY –ESC University;
- 2) Rikonceptim të syllabuseve përmes përfshirjes së tematikës së orëve laboratorikë dhe ushtrimeve;
- 3) Institucioni ofron mundësitë për të inkurajuar pjesëmarrjen e stafit akademik në konferenca, botime shkencore përmes zbatimit të politikës së matjes dhe vleresimit të performancës akademike;
- 4) Diversifikimi i burimeve të financimit;
- 5) Rritja e bashkëpunimit me universitete brenda vendit dhe ato rajonale.

d. Pengesat:

- 1) Konkurrenca me universite të tjera për programe të ngjashme;
- 2) Ndryshimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor dhe nënligjor të arsimit të lartë në Shqipëri;
- 3) Tarifë relativisht e lartë e shkollimit;
- 4) Vështirësitë për sigurimin e personelit akademik efektiv me kualifikimin e kërkuar.

Rekomandime:

- a) *Rekomandojmë zbatimin e strategjisë në kërkim tregu me fokus të veçantë në përthithjen e studentëve në këtë fushë përmes kombinimit të tij me politika të qarta marketingu veçanërisht për këtë program studimi.*
- b) *Rekomandojmë një konsolidim të mëtejshëm të Qendrës për Kërkime të Avancuara Kompjuterike përmes zbatimit të një strategji afatgjatë të Fakultetit të Informatikës në drejtim të kërkimit Shkencor. Rekomandojmë një fuqizim të punës së saj me impakt në cilësinë e programit të studimit*

dhe të Fakultetit të Informatikës në tërësi. Ndonëse në rang institucional janë ngritur tre Qendra Kërkimore nuk gjejmë evidenca të qarta në lidhje me mënyrën e koordinimit dhe bashkëveprimit të tyre në funksion të rritje së kërkimit shkencor.

- c) Plani mësimor është në akordancë me standartet dhe VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 ndonëse rekomandojmë një përmirësim të tij në lidhje me vendosjen e praktikave profesionale e cila u konsiderua e nevojshme edhe nga ana e studentëve.
- d) Rekomandojmë që në syllabuse të shprehen qartë edhe tematika e seminareve dhe orët laboratorike për të krijuar një konceptim më të qartë të trajtimit të teorisë në aspektin praktik dhe laboratorik.

**SUMMARY ANALYSIS FOR COMPLETION OF RECOMMENDATIONS FROM THE
ANTECEDENT ACCREDITATION**

Reccomendation a)	is met
Reccomendation b)	is met
Reccomendation c)	is met

**SUMMARY ANALYSIS OF EXTERNAL EVALUATION REPORT BASED ON THE SWOT
METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS)**

a) Strengths:

- 1) High labor market demand for graduate students in this academic profile;
- 2) Guaranteed student employment at the end of their studies;
- 3) The opportunity of a double degree through co-operation with New York State University, Empire State College, USA.
- 4) The academic program is offered in English language, enabling thus students to be employed in foreign companies or abroad.
- 5) The institution provides financial sustainability for the development of the academic program;
- 6) The Institution provides an appropriate and modern infrastructure (lecture halls, workshops and laboratories) guaranteeing thus the teaching quality.
- 7) By offering an academic program in English language, the institution enables the use of an extensive range of contemporary literature by eliminating thus the need for their translation in Albanian.
- 8) The high quality of the curriculum offered for academic programs based on the US model
- 9) The institution has established a monitoring and measurement facility for the quality of the study program, in particular, and the university as a whole;
- 10) The institution engages foreign and domestic academic staff with appropriate professional degrees and experience;
- 11) A library that has extensive basic and auxiliary literature in service of the academic program aswell as extensive access to various electronic libraries;

b) Weaknesses:

- 1) Frequent changes regarding the duration of the BSc program in Computer Science with "Information Systems" profile (engendered by the need to adapt to changes in the legal and sub-legal acts of higher education in the country);
- 2) Lack of an updated market research in accordance with the UNYT Labor Market Research Strategy;
- 3) Lack of coordination and cooperation between the Center for Advanced Computer Research and the Faculty and other scientific centers of the University.
- 4) Lack of professional practices in this academic program.

c) Opportunities:

- 1) The opportunity of a dual diploma offers the institution the possibility of following student acceptance and transfer criterias at SUNY -ESC University;
- 2) Reconciliation of the syllabi through the inclusion of laboratory hours and exercises;
- 3) The Institution offers opportunities to encourage academic staff participation in conferences, scientific publications through the implementation of the policy of measurement and assessment of academic performance;
- 4) Diversification of financial resources;
- 5) Enhancement of cooperation with national and regional universities.

d) Threats:

- 1) Competition from other Universities for similar academic programs;
- 2) Continuous change of the legal and sub-legal framework of higher education in Albania;
- 3) Relatively high tuition fees;
- 4) Difficulties in obtaining effective academic staff in possession of the required qualifications.

Recommendations:

- 1) *The implementation of a labor market research strategy with a particular focus on student accumulation in this area through its combination with clear marketing policies designed specifically for this academic program.*
- 2) *Further consolidation of the Center for Advanced Computer Research through the implementation of a long-term strategy of the Faculty of Informatics in terms of scientific research. We urge an empowerment of its work that would positively impact the quality of the study program and the Faculty of Informatics as a whole. Although three Research Centers have been set up at institutional level, there is no clear evidence of their coordination and interaction resulting in increased scientific research.*
- 3) *The curriculum is in line with standards and DCM no. 41 date 24.01.2018. Nevertheless, we recommend an improvement in the establishment of professional practices, a step that was deemed necessary by students as well.*
- 4) *The syllabi need to clearly relate the topics of seminars and laboratory hours in order to create a better understanding on how theory should be handled in the practical and laboratory aspect.*

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Dr. Alketa Grepcka

Prof. Dr. Thoma Korini

